



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:
“Financë” me profile “Bankë dhe Tregje Financiare”, “Auditim dhe
Menaxhim Risku”, “Kontabilitet dhe Raportim Financiar”, “Administrim
Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh”
i
Institucionit të Arsimit të Lartë
“Universiteti European i Tiranës ”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc. Dr. Dorina KRIPA

Prof.Asoc. Dr. Brikena LEKA

Shkurt / 2020

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT

Universiteti Europian i Tiranës, UET, e ushtron aktivitetin bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". UET është krijuar me Vendimin nr. 636 datë 20.09.2006 të Këshillit të Ministrave "Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike". Universiteti Europian i Tiranës ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.12, date 07.04.2017, me kohëzgjatje 5 vite akadmeike, me afat vlefshmërie deri në 06.04.2022. Programi i ciklit të dytë të studimit Master Profesional në "Financë", është hapur me Urdhër të Këshillit të Ministrave Nr. 74, datë 21.01.2009, si Master i Nivelit të Parë në "Banka dhe Sigurime", me 3 profile. Programi është akredituar për herë të parë me Urdhër Nr. 68, datë 14.02.2011. Programi u riorganizua me Urdhër Nr. 233, datë 06.06.2013 në Master Profesional "Financë", me 5 profile. Akreditimi periodik i programit u bë me Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 20, datë 11.05.2018, me kohëzgjatje 6 vite. Duke u mbështetur në hapësirën ligjore të krijuar me ndryshimet në legjislacionin e ri për arsimin e lartë, të rrjedhura nga Ligji Nr 80/2015 dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018, për vitin akademik 2018-2019, ky program studimi ofrohet i përshtatur dhe me emërtimin e ri si Master Profesional në: "Financë" me profile "Bankë dhe Tregje Financiare", "Auditim dhe Menaxhim Risku", "Kontabilitet dhe Raportim Financiar", "Administrim Publik", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh", në përputhje me Urdhërin e MASR Nr.661, datë 12.10.2018. Ky është një program i ciklit të dytë të studimeve, dhe ofrohet me kohëzgjatje normale një vit akademik, me gjithsej 60 ECTS. Hapja e këtij programi mbështetet në strategjinë institucionale të UET, të zbatuar konkretisht për studimet në fushën ekonomike, si dhe përmbushjen e objektivave strategjike institucionale, ato të Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, si dhe atyre të vetë Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës.

Objektiva strategjike të këtij programi janë:

1. Formimi akademik dhe shkencor bashkëkohor, i studentëve si ekspertë dhe specialistë cilësorë si në aspektet teorike ashtu edhe në aftësitë praktike aplikative në fushën e bankave, sigurimeve, politikave e sistemeve fiskale, kontabilitetit e raportimit financiar si dhe auditimit të institucioneve publike dhe atij të sektorit privat;
2. Ofrimi i një diplome cilësore dhe elitare në fushën e financës së aplikuar në Shqipëri;
3. Përputhja dhe përshtatja optimale e dijeve akademike të ofruara, me mjeshtëritë e kërkuara në tregun e punës dhe mundësimi i një niveli të kënaqshëm punësimi;
4. Tërheqja e një numri të konsiderueshëm studentësh;

Programi ofrohet nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, në Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, i licensuar si Fakulteti Ekonomik me VKM Nr. 255, datë 27.02.2008, dhe i riorganizuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 527, datë 04.09.2018.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master Profesional në "Financë me profile", të ofruar nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, pranë Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti Europian i Tiranës" filloi me trajnimin pranë ASCAL, marrjen e dokumentacionit të ofruar nga UET, si dhe ndarjen e punës për përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë. ASCAL bazuar në *"Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017"*, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UET, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Asoc. Dorina Kripa dhe Prof. Asoc. Brikena Leka. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Në bashkëpunim dhe me specialisten e ASCAL, u caktuan datat e vizitës në institucion si dhe u përgatit axhenda e takimeve që do të realizoheshin. Axhenda iu dërgua institucionit, i cili ra dakort me të. Përpara vizitës në institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm bëri një takim face to face me kordinatoren e ASCAL, ku u diskutuan elementë të vlerësimit të programit. Vizita dy ditore në institucion u zhvillua në datat 16 dhe 18 dhjetor 2019. Gjatë kësaj vizite dy ditore, GVJ u takua me: Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit që njëkohësisht është edhe Përgjegjës i komanduar i Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, grupin e vetvlerësimit, pedagogët e aktivizuar në këtë program studimi, studentë të këtij programi, përfaqësues të komisionit të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zyrës së kurrikulave, përfaqësues të zyrës së projekteve dhe partneriteteve, përfaqësues të zyrës së këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit, përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore dhe financës dhe përfaqësues të sekretarisë mësimore. Gjithashtu u vizituan ambjentet e institucionit ku zhvillohet mësimi për këtë program studimi, si edhe ambjentet e bibliotekës. Pas vizitës në Institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm diskutoi për çështje dhe problematika që dolën gjatë leximit dhe analizës të materialeve të paraqitura nga institucioni, diskutimeve gjatë ditëve të takimit, si dhe leximit dhe analizës së materialeve shtesë që iu kërkuar institucionit në ditën e dytë të vizitës. Më tej ky grup filloi punën për hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm. Në përfundim të këtij procesi, grupi përgatiti dhe dorëzoi draft raportin tek eksperti i ASCAL.

Universiteti Europian i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 14.02.2020, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 9/21 Prot, datë 14.02.2020. Universiteti Europian i Tiranës përcjell pranë ASCAL më datë 20.02.2020, nëpërmjet shkresës me Nr. 06/13 Prot, datë 19.02.2020, *"Përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin MP Financë"*, komente mbi draft raportin. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. Lidhur me komentin që bëhet për *Standardin II.1, kriteri 2*, **nuk ka ndryshime në raport** E kuptojmë detyrimin që totali i krediteve për lëndët e profilit duhet të zërrë deri 30% të totalit të krediteve, por lëndët e karakterit profesional mund të kenë numër më të vogël

kreditesh, duke respektuar kriteret në VKM Nr. 41. Gjithashtu, mund të shihet mundësia që një nga lëndët e përfshira në profil që është më e karakterit shkencor, të përfshihet në trung.

Për sa i përket komentit për profilet e manaxhimit i qëndrojmë opinionit tonë se nuk mund të krijohet profilizimi i duhur në manaxhim me tre lëndë të karakterit profesional, pra minimalisht duhet të shtohet një lëndë profili.

Ndërkohë, biem dakord me komentin që në rregullore, objektivat e programit kanë qenë madhore në fushën e bankave, sigurimeve, politikave e sistemeve fiskale, kontabilitetit e raportimit financiar si dhe auditimit të institucioneve publike dhe atij të sektorit privat. Kjo gjë është reflektuar në raport.

2. Lidhur me komentin që bëhet për *Standardin II.2, kriteri 2*, mendojmë që nuk është kuptuar mirë komenti ynë. Pra: “*Bie në sy një lëvizje e konsiderueshme e stafit akademik efektiv. Kjo ndikonte në masën e angazhimit në kurrikulën e programit të stafit ekzistues*”.

Në Departamentin e Ekonomiksit dhe Financës, që është edhe departamenti përgjegjës për hartimin e kurrikulës së këtij programi ka pasur lëvizje të konsiderueshme stafi akademik efektiv nga viti akademik 2018-2019 (kryesisht viti 2018-periudha kur është miratuar programi) në vitin akademik 2019-2020. Kanë lëvizur 5 staf akademik nga 18 staf gjithsej, ku 4 prej tyre kanë qenë të kategorisë profesor, ndërkohe 2 prej tyre me post të lartë, përfshirë edhe përgjegjësin e departamentit. Pra për këtë kriter **nuk ka ndryshime në raport.**

3. Lidhur me komentin që bëhet për *Standardin II.2, kriteri 3*, **nuk ka ndryshime në raport.** pasi ligji i arsimit të lartë kërkon që pedagogët që japin mësim në program master duhet të zotërojnë gradën Doktor i Shkencave. Në raport është evidentuar nga ana jonë kompetenca profesionale e dy pedagogëve, që japin mësim në këtë program.
4. Lidhur me komentin që bëhet për *Standardin II.4, kriteri 4*, **nuk ka ndryshime në raport.** Sylabuset nuk mund të jenë të njëjta pothuaj për të gjithë lëndët që zhvillohen si në masterin profesional, ashtu edhe në masterin shkencor. Tematika teorike e lëndës, ilustrimi me shembuj praktik, research papers që trajtohen e diskutohen, duhet të jenë në funksion të kompetencave të domosdoshme për një student që studion në master profesional kundrejt atyre që studiojnë në master shkencor. Këto diferenca për shumicën e lëndëve duhet të reflektohen në sylabus. Ndërkohë në komentin tuaj thuhet që lëndët zhvillohen në fasha të ndara mësimore. Gjatë vizitave në institucion, në takimet me studentët e këtij programi, u konstatua që lëndët zhvilloheshin bashkë me studentët e masterit shkencor.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:

“Financë” me profile “Bankë dhe Tregje Financiare”, “Auditim dhe Menaxhim Risku”, “Kontabilitet dhe Raportim Financiar”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Ky institucion ofron programe studimi të cilat janë në shërbim të shoqërisë, ekonomisë, politikës dhe zhvillimit të qëndrueshëm afatgjatë. Në vizionin e tij, UET ka prioritet në aktivitetin e përditshëm kërkimet shkencore teorike dhe aplikative me fokus “studimet shqiptare e rajonale” në funksion të zhvillimit ekonomik, social e kulturor. (dokumenti numër 3 Plani strategjik 2015-2020).
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	UET ka si objektiv thellimin e traditave më të mira universitare shqiptare, si dhe të kontribuojë në thellimin e lirisë akademike, dëshirës për ndjekjen e studimeve universitare, krijimin e disiplinës akademike e intelektuale në emër të karrierave sa më të qëndrueshme e cilësore, vullnetin për ta parë universitetin si qendër të inovacionit dhe zhvillimit si dhe thellimin e sensit të komunitetit dhe bashkëpunimit. (dokumenti numër 3: Plani strategjik 2015-2020).
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Master Profesional në Financë është një program i ciklit të dytë të studimeve, dhe ofrohet me kohëzgjatje normale një vit akademik, me gjithsej 60 ECTS. Hapja e këtij programi mbështetet në strategjinë institucionale të UET, të zbatuar konkretisht për studimet në fushën ekonomike, si dhe përmbushjen e objektivave strategjike institucionale, ato të Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, si dhe atyre të vetë Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës. (dokumenti numër 4 Plani Strategjik i Programit Master Profesional në Financë).
Kriteri 4 Programet e	Programi i studimit Master Profesional në Financë paraqitet në

studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	përputhje dhe në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit. Sfera ekonomike ka pasur dhe vazhdon të ketë rëndësinë kryesore të zhvillimit të vendit tonë, dhe programet e studimit në këtë fushë dhe rritja e cilësisë së tyre në kuadrin dhe rëndësinë kombëtare, paraqitet me rëndësi strategjike për vendin, për zhvillimin e ekonomisë dhe tregun e punës. Programi i studimit është modeluar me 5 profile: “Bankë dhe Tregje Financiare”, “Auditim dhe Menaxhim Risku”, “Kontabilitet dhe Raportim Financiar”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”. Sipas planit strategjik të këtij program studimi, qëllimi ka qenë përshtatja e programit me kërkesat aktuale të tregut të punës, i cili kërkon dije multidisiplinare, si dhe në përmbushje të objektivit strategjik të UET për profilizimin e universitetit si një “universitet i biznesit”, duke i dhënë përparësi ndërtimit të kurrikulave, strukturës së programeve e diversitetit të diplomave e profileve në funksion të kërkesave të tregut të punës në nivel kombëtar e rajonal.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit Master Profesional në Financë me profilet përkatëse përshtatet me strategjinë e zhvillimit të UET, e cila përmban arritjen e ekselencës në aktivitete akademike e kërkimore, sigurimi i një cilësie të lartë në procesin akademik, pajisja e studentëve me njohuri e aftësi praktike duke integruar mësimdhënien me kërkimin shkencor dhe krijimin e një mjedisi nxitës dhe zhvillues drejt edukimit më të mirë. Pas shqyrtimit të planit strategjik të UET në periudhën 5 vjeçare 2015-2020, GVJ vuri re se prioritetet strategjike janë kërkimi shkencor, cilësia dhe performanca akademike, dhe bashkëpunimet brenda dhe jashtë vendit, të cilat krijojnë një mjedis që promovon të mësuarin e angazhuar, interaktiv duke i shërbyer edhe dialogut konstruktiv në nivel institucioni.

	(dokumenti numër 3: Plani strategjik 2015-2020).			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Programi MP Financë me profile është në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit në fuqi. Në Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të UET gjejmë të përcaktuar mënyrën e organizimit të institucionit, kompetencat e organeve drejtuese akademike, kolegiale dhe administrative si dhe të autoriteteve drejtuese të institucionit, të njësive kryesore dhe të njësive bazë. UET synon ruajtjen e profilizimit të tij kryesor në shkencat ekonomike, financiare, menaxheriale, jurisprudencës, shkencave politike e sociale, edukimit, TI, komunikimit, etj., por mbetet i hapur ndaj diversifikimit të ofertës së tij akademike e shkencore dhe në drejtime të tjera që vlerësohen se kërkohen nga tregu i punës dhe UET ka mundësitë njerëzore e financiare për t'i aplikuar ato. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe vizitat e kryera pranë institucionit, u vu re qartë se ky program studimi ka për qëllim ofrimin e njohurive multidisiplinare dhe ofrimin e një game sa më të gjerë programesh me qëllim plotësimin e çdo kërkesë për programe studimi. (referuar dokumentit numër 3: Plani strategjik 2015-2020). (referuar dokumentit numër 2. Statuti i UET) (referuar dokumentit numër 5. Rregullore e UET)			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Emërtimi dhe organizimi i programit të studimit MP në Financë është në përputhje me drejtimit akademike të përcaktuara në dokumentet themelore të UET. Ky program studimi zhvillohet në fushën e Financës dhe është në përgjegjësinë e departamentit të Ekonomiksit dhe Financës. Ai është i strukturuar sipas ligjit dhe VKM Nr. 41 dt 24.01.2018 (referuar dokumenti numër 53).			
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional" hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	Komunikimi i ngushtë çdo gjashtë muaj me Bordin e Punës, ku kryesisht përbëhet nga ish alumni të UET, synon përshtatjen e kurrikulave dhe programeve të studimit sipas tendencave të tregut shqiptar dhe atij më gjerë. Gjithashtu edhe zhvillimi i vazhdueshëm i panairëve të punës ku i pranishëm është biznesi shqiptar, ndihmon përshtatjen e kurrikulave me nevojat e tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi I.3

Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Nga vizita pranë institucionit me grupet e interesit u konstatua se në përputhje me objektivat e përcaktuara nga UET në kuadër të riorganizimit të UET, është bërë standartizimi i programeve të studimit MP me 5 profile, dhe siç u pohua nga drejtuesit dhe stafi, kjo me qëllim manaxhimin më të mirë të portofolit të lëndëve, ofrimin e një numri sa më të gjerë diplomash masteri që mbulojnë të gjitha profilet e fushës Financë. Madje profilizimi synon të tejkalojë fushën e financës drejt fushës së biznesit, konkretisht me dy profilet: “Administrim publik” dhe “Menaxhim dhe vlerësim projektesh”. <i>Por në opinionin tonë, përmbajtja e programit duhet rishqyrtuar me qëllim rritjen e aftësive dhe kompetencave që synon të ofrojë secili profil. Rekomandojmë shtimin e lëndëve të profilit dhe pakësimin e lëndëve teorike.</i>
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Edhe pse në dokumentacionin bashkëngjitur theksohet se nuk ka një analizë tregu, nga vizita pranë institucionit u konstatua se UET zhvillon analiza të pjesshme, siç është për shembull bashkëpunimi me partnerë të tjerë në projektin ERASMUS+ KA2, “GRADUA”. Ky projekt synon të krijojë në Shqipëri një platformë inovative të bazuar në teknologjine e informacionit për ndjekjen e të diplomuarve në lidhje me punësimin e tyre. Gjithashtu konsultimet me Bordin e Punës shërbejnë për orientimin më të mirë drejt kërkesave të tregut për specialistë. Zhvillimi i panairove të punës dhe “Open Weeks” për studentët e nivelit master, orientojnë më mirë studentët drejt mundësive të punësimit. Këtë gjë e ndihmon edhe caktimi pranë çdo departamenti të një këshillues karriere. Zyra e Këshillimit dhe Kujdesi ndaj studentit ndihmon në mbajtjen e një baze të dhënash të studentëve alumni dhe të punësimit real të tyre. <i>Theksojmë se ky program studimi i hartuar në vitin 2018 në kuadër të riorganizimit të institucionit dhe programeve të studimit ka ende nevojë për të vlerësuar reagimin e tregut</i>

	<i>ndaj diplomave të këtyre profileve, përderisa nuk ka dhe një studim të mirëfilltë tregu për këtë program.</i>
Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Ky program studimi është strukturuar sipas kriterëve të arsimit të lartë, sipas objektivave të institucionit dhe perceptimit të nevojave të tregut të punës nga ky institucion. Në lidhje me përmbajtjen e programit në funksion të përgjigjes së nevojave të tregut, <i>mendojmë se ky profilizim në 5 profile brenda një masteri me 60 kredite, ku diferencën e përbëjnë vetëm 2-3 lëndë, mund të mos jetë tërësisht i realizueshëm.</i> Gjithsesi këtë gjë do ta vlerësojë më mirë tregu, pasi të diplomuarit e parë janë vetëm 33 studentë në sezonin korrik 2019.
Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	<i>Ky program studimi është hartuar i tillë më së shumti në funksion të zgjerimit të diplomave të ofruara nga UET konkretisht në fushën e financës, sesa në funksion të përafrimit me programe të ngjashme të institucioneve ndërkombëtare.</i> Gjithashtu, sipas opinionit të drejtuesit të departamentit, filozofia e përdorimit të të njëjtave sylabuseve për lëndë të njëjta midis dy niveleve të masterave në Financë: Master i Shkencave dhe Master Profesional, me të njëjtat profile, duke ruajtur bërthamën e masterit profesional e mbi këtë bazë zhvillimin më tej të Masterit të Shkencave, lehtëson mundësitë e transferimit nga masteri profesional në masterin e Shkencave. Në këtë program studimi mund të transferohen studentë nga programe të tjera të studimit të ciklit të parë, në fushë të njëjtë ose të përafërt, vetëm në fillim të vitit akademik. Studentët që kanë përfunduar studimet në një program tjetër studimi, kanë të drejtë të kërkojnë njohjen e krediteve të lëndëve të njëjta ose të ngjashme. Masterat profesionalë me 60 kredite, më shumë sesa në kurrikulat e vendeve të zhvilluara, mbështeten në perceptimin e institucionit se cilat janë nevojat e tregut, dhe sesa i mirë është ky program studimi duhet të pritët reagimi i tregut kundrejt punësimit të të diplomuarve të parë. <i>(referuar dokument numër 7: Rregullore e programit të studimit MP Financë).</i>
Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe	Nga shqyrtimi i akteve të vëna në dispozicion nga institucioni konstatohet se sylabuset janë përditësuar sipas modelit që është pjesë e VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga

profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.	institucionet e Arsimit të Lartë”. Çdo program ka të pasqyruar përmbajtjen e detajuar dhe është vlerësuar në kredite sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS). Programet e studimeve në UET organizohen në përputhje me procesin e Bolonjës, në tre cikle: të parë, të dytë dhe të tretë. Ato janë me kohë të plotë dhe të shprehur në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Kjo pasqyrohet në Rregulloren dhe Statutin e UET. <i>(referuar dokumentit numër 2. Statuti i UET)</i> <i>(referuar dokumentit numër 5. Rregullore e UET)</i>			
Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Ky program studimi është vazhdimësi e eksperiencës shumë të mirë të Masterit Profesional në Financë të licensuar në vitin 2009. Programi i studimit ofron mundësinë e profilizimit, përmes zgjedhjes së grup-lëndëve të kategorisë C të programit, të cilat rekomandojmë të rishikohen. Studenti mund të zgjedhë një nga këto profile studimi: a. Bankë dhe Tregje Financiare; b. Auditim dhe Menaxhim Risku; c. Kontabilitet dhe Raportim Financiar; d. Administrim Publik; e. Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh. Synimi i programit të studimit është plotësimi i nevojave të tregut, dhe fakt nga vizitat pranë institucionit ishte që studentët e këtij nivel studimi janë kryesisht të punësuar aktualisht.			
Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	Sipas Planit Strategjik 2015-2020 të UET, si dhe vizitave pranë institucionit, për studentë të huaj Erasmus, lëndët ofrohen dhe në gjuhë anglisht (në varësi të disponueshmërisë së pedagogut të lëndës).			
Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	Ofrimi i këtij program studimi i profilizuar në 5 drejtime mundëson specializimin në fushën e bankëut, tregjeve kapitale, auditit, kontabilitetit, administrimit publik dhe vlerësimit të projekteve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4

Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UET është një IAL me eksperiencë të konsiderueshme në Republikën e Shqipërisë. Kjo i ka dhënë mundësinë që në vite të krijojë një përvojë dhe një kapacitet burimesh njerëzore në fushën akademike në përshtatje me qëllimin kryesor të këtij institucioni, përcjelljen e dijes tek studentët. Programi i studimit MP në Financë ka një eksperiencë mbi 10 vjet. Aktualisht ofrohet pranë Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, i cili ka për vitin akademik 2018-2019: 18 staf akademik efektiv (PAE), nga të cilët 8 me titull Profesor, 3 me gradë shkencore Doktor dhe 7 Msc (<i>dokumenti 23 bashkëngjitur nga UET</i>). Gjatë vitit aktual akademik 2019-2020, Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës përbëhet nga 13 staf akademik efektiv (PAE), nga të cilët 4 me titull Profesor, 3 me gradë shkencore Doktor dhe 6 Msc. Stafi akademik është i kualifikuar për zhvillimin e këtij program studimi. Megjithatë duke qenë program ndërdisiplinor, ai mbështetet dhe me personel akademik të departamentit të Manaxhimit dhe Marketingut me cilësinë dhe përvojën e duhur. Referuar (<i>dokumentit 24. Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin studimit</i>) Për vitin akademik 2018-2019, në programin e studimit MP në Financë, janë të aktivizuar në mësimdhënie 13 pedagogë efektivë (PAE) dhe 2 pedagogë të ftuar (PAK). I gjithë stafi mësimdhënës që mbulon këtë program studimi përmbush kriterin e gradës/titullit akademik (4 profesorë të asociuar dhe 3 doktorë), ndërkohë 2 pedagogë (1 efektiv dhe 1 i ftuar) nuk përmbushin kriterin e gradës doktor. Pedagogu efektiv është Msc Audites ligjor, ndërsa pedagogu i ftuar mban titullin ndërkombëtar të profesionistit kontabël ACCA. Gjatë vitit aktual akademik 2019-2020, në këtë program studimi janë aktivizuar në mësimdhënie 9 pedagogë efektivë (PAE) dhe 4 pedagogë të ftuar (PAK). Stafi mësimdhënës përmbush kriterin e gradës/titullit akademik (6 profesorë dhe 5 doktorë), ndërkohë 2 pedagogë (1 efektiv dhe 1 i ftuar) nuk përmbushin kriterin e gradës doktor. Pedagogu efektiv

	është Msc Auditues ligjor, ndërsa pedagogu i ftuar mban titullin ndërkombëtar të profesionistit kontabël ACCA.			
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga IAL, por edhe nga informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion, konkludohet se ka një përputhshmëri të plotë dhe cilësore midis fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse për programin e studimit.			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Gjithashtu, duke qenë se ky program studimi është ndërdisiplinor, pra zhvillohet pranë Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, por njëkohësisht mbështetet dhe nga Departamenti i Manaxhimit dhe Marketingut (për dy profile), përputhja është sërish e plotë dhe cilësore.			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Ky program studimi ofrohet në përputhje me profilin dhe ekspertizën e njësisë kryesore dhe asaj bazë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të

realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Në funksion të realizimit të programit të studimit, institucioni ka hartuar një sërë rregulloresh dhe dokumentash, përmes të cilëve mbikëqyr zhvillimin e tij. Përmes këtyre dokumentave, ndahen detyrat dhe përgjegjësitë midis njësive dhe zyrave përgjegjëse. Njësia bazë ku zhvillohet programi është departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, i mbështetur nga departamenti i Manaxhimit dhe Marketingut. Gjithashtu në proces përfshihen një sërë zyrash për mbikëqyrjen e procesit mësimor, zhvillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit, njësia e sigurimit të cilësisë, ambjentet dhe biblioteka në dispozicion, si dhe koordinatori i programit.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Duke qenë një program studimi tërësisht me karakter profesional, institucioni ka vënë theksin në marrëdhëniet me institucionet financiare dhe bankare si dhe biznesin vendas, pikërisht për të bërë të mundur dhe realizimin e praktikave profesionale dhe rritjen e mundësive të punësimit. Panairët e punës dhe "Open weeks" janë karakteristike për këtë institucion.
Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë "Master profesional", institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	UET ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me institucione dhe biznese për realizimin e praktikave. Rendisim disa prej tyre, si: INSTAT, AMF, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Raiffeisen Bank, Tirana Bank, OTP Bank, Vodafone Albania, AK Invest, etj. Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve pranë UET është angazhuar në grupe kërkimore për projekte me institucione vendase e të huaja, ndërsa Zyra e Karrierës kujdeset për zgjerimin e bizneseve partnere përmes Panairit të Punës në UET dhe siguron përtej praktikës mësimore, punësimin e studentëve.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.	Zhvillimi i praktikës është i drejtuar nga mbikëqyrësi përkatës dhe ka një sërë dokumentash që e rregullojnë këtë proces. UET e konsideron zhvillimin e praktikës mësimore një fazë të rëndësishme që lidhet me formimin praktik të studentëve si dhe me mundësi më të mira punësimi. Kjo veprimtari është përmirësuar dukshëm vitet e fundit si pasojë edhe e përpjekjeve të vazhdueshme për rritjen dhe funksionimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Edhe riorganizimi i programeve është kryer në funksion të orientimit drejt praktikës, duke standartizuar profilizimin e masterave

	profesionalë me 5 profile.			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Ky program studimi ka vitin e tij të parë periudhën 2018-2019. Të dhënat e vëna në dispozicion nga institucioni i përkasin kryesisht të diplomuarve me programin e mëparshëm të studimit. Për këtë vit akademik, edhe sipas RVB, nuk ka ndonjë trajnim specifik profesional për studentët e këtij programi. Megjithatë, institucioni angazhon edhe zyrtar mbështetës si p.sh. zyra e karrierës e cila organizon alumnit, ndjek vazhdimësinë e tyre në punë që të vlerësojë përputhjen e dijeve me kërkesat e tregut.			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Analiza e departamentit për arritjen e objektivave të programit vlen pjesërisht për të vlerësuar përfitimet nga bashkëpunimi me institucione dhe biznesin. <i>(referuar dokumentit numër 38 bashkëngjitur).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve	Nga dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni konfirmohet që programi i studimit Master profesional "Financë me profile" organizohet sipas ligjit, në lëndë e module ku secila vlerësohet me kredite sipas sistemit ECTS. Programi i studimit është i organizuar në përputhje me legjislacion vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi është i organizuar në lëndë dhe module, si dhe secila prej lëndëve duke përfshirë edhe praktikën

(ECTS).	janë të vlerësuara me nga 6 kredite. Punimi i diplomës/ provimi i përgjithshëm formimi vlerësohet me 12 kredite. Programi në total ka 60 kredite. Informacioni i detajuar për kurrikulën e programit gjenden në <i>dokumentin 14 bashkëngjitur nga UET</i> .
Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	Ky program, ashtu si edhe të gjithë programet master profesional/shkencor që ofron ky Institucion ka 5 profile, duke pasur në fokus krijimin e profileve të ndërdisiplinarizuar. Në këtë kuadër edhe pse masteri profesional është në fushën e financës, departamenti ka gjykuar që të ketë dy profile në fushën e manaxhimit: “<i>Administrim publik</i>” dhe “<i>Manaxhim dhe vlerësim projektesh</i>”. Pavarësisht se mbështesim ndërdisiplinarizimin, mendojmë që studentë të cilët kanë marrë baza shumë të forta në financë në studimet në trung (me tre lëndë për përgatitje për disiplinë shkencore) dhe një lëndë (për përgatitje metodologjike), nuk mund të krijojnë një profil të specializuar në fushën e manaxhimit vetëm me tre lëndë në këtë fushë. Një student që dëshiron të profilizohet në fushën e manaxhimit mendojmë se duhet të ketë baza të forta në fushën e manaxhimit. <i>Rekomandojmë që të rishikohet kurrikula e këtij programi për të dy profilet “Administrim publik” dhe “Manaxhim dhe vlerësim projektesh” duke ulur numrin e lëndëve në trung (maksimumi 2) dhe të shtohen 1-2 lëndë në profile, që të bëhet i mundur formimi i shprehive të nevojshme për secilin prej profileve.</i> Referuar të dhënave (<i>dokumenti 27 bashkëngjitur nga UET</i>) këto janë edhe dy profilet që zgjidhen më pak nga studentët: 9 studentë “Administrim publik” dhe 2 studentë “Manaxhim dhe vlerësim projektesh”, nga 102 studentë për vitin 2018-2019. Ndërkohë për vitin akademik aktual kanë përzgjedhur 3 studentë “administrim publik” dhe 1 student “manaxhim dhe vlerësim projektesh” nga 74 studentë për vitin 2019-2020.
Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Programi i studimit Master Profesional në Financë, synon ta pajisë studentin me koncepte teorike dhe shkencore në fushën e financës, koncepte të aplikuara dhe të specializuara vecanërisht për profilet: Banka dhe Tregje Financiare si dhe Kontabilitet dhe Raportim Financiar. Studentëve iu ofrohet mundësia e realizimit të praktikës pranë institucioneve (bizneseve) me të cilët UET ka marrëveshje bashkëpunimi. Në fund realizohet një punim diplome për studentë me mesatare në hyrje së paku 7,5, ndërsa studentët e tjerë japin një provim përmbyllës por edhe ky në trajtën e një rasti studimi në mënyrë që të jetë sa më praktik dhe afër realitetit. Ky informacion gjendet edhe në materialin 7

	bashkangjitur UET, për rregulloren e programit.
Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Ky program studimi ofron njohuri të avancuara në fushën e financës. Ai synon të formojë specialistë cilësorë në fushën e financës, bankës dhe auditimit. Siç u shprehëm edhe më lart kemi rezerva për specialistë në fushën e Administrimit publik dhe Manaxhimit dhe vleresimit të projekteve. <i>Gjithashtu u bë me dije gjatë takimeve me dekanin dhe pedagogët, që në profilin Auditim dhe Manaxhim Risku nuk ka asnjë lëndë me fokus manaxhimin e riskut.</i>
Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Nga shqyrtimi i kurrikulës së programit MP në Financë (<i>dokumenti 14 Kurrikula e programit të studimit MP në Financë</i>) GVJ konstaton se programi i studimit MP në Financë ofrohet me 60 ECTS, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik. Struktura e programit Master profesional në Financë është në përputhje të plotë me Ligjin e arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore përkatëse, duke përfshirë një tërësi lëndësh formuese dhe specializuese për studentët. Gjithashtu programi është i shpërndarë me ngarkesat përkatëse sipas formave të zhvillimit të njohurive, leksione, seminare, laboratore, praktika mësimore, temë diplome. Evidentimi është i qartë (<i>përmes dokumentit 14 Kurrikula e programit të studimit MP në Financë</i>).
Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Në rregulloren e programit të studimit, duke u bazuar edhe në Vendimin nr 41, dt 24.01.2018, specifikisht pikat 3 dhe 4 paraqiten, grupet e klasifikimit të veprimtarive formuese dhe disiplinave të programit, të pasqyruara në programin e studimit dhe kreditet përkatëse. Ky program studimi zgjat 1 vit akademik dhe ka 60 ECTS. Lëndët ndahen në: - Kategorinë A- Lëndë Bazë me 6 ECTS zënë 10% të krediteve (brenda kufijve ligjor 5%-10% të krediteve); - Kategorinë B- Lëndë Karakterizuese me 18 ECTS zënë 30% të krediteve brenda kufijve 30%-40% të krediteve); - Kategorinë C- Lëndë Ndërdisiplinore me 18 ECTS zënë 30% të krediteve brenda kufijve 20%-30% të krediteve); - Kategorinë D- Lëndë Plotësuese (Praktikë) me 6 ECTS zënë 10% të krediteve (brenda kufirit 10% të krediteve); - Kategorinë E- Detyrime Përmbyllëse (Punimi i diplomës/Provimi i përgjithshëm formimi) me 12 ECTS zënë 20% të krediteve (brenda kufijve 10%-20% të krediteve);

	<i>(Dokumenti 7. Rregullore e programit MP Finance)</i>			
Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	Në këtë program studimi, praktikës profesionale i janë caktuar 6 kredite që përkon me përcaktimin ligjor të 10% të totalit të krediteve të Programit Master Profesional. Meqënëse ngarkesa për një ECTS parashikohet në ligj 25 orë pune, atëherë studentët plotësojnë një total prej 150 orë pune, të cilat konsistojnë në: 8 orë pune në auditor (4 seanca nga 2 orë), 120 orë pune në institucionin ku zhvillohet praktika dhe 22 orë janë punë individuale e studentit. Në përfundim të praktikës studenti harton një raport përfundimtar, si edhe bën një vetvlerësim për praktikën e ndjekur. <i>(Dokumenti 32.2 B.I Mbi praktikën profesionale)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore dhe njësia bazë përmbushin të gjitha detyrimet ligjore që kërkohen për programin e studimit. Departamenti i Ekonomiksit dhe i Financës është përgjegjës për mbarëvajtjen e këtij masteri. Ky fakultet është licensuar me VKM Nr. 255, datë 27.02.2008 dhe riorganizuar me Urdhër të Ministrit Nr. 527, datë 04.09.2018. UET është institucion i akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 12, datë 07.04.2017, si dhe Vendim Nr. 46, datë 05.07.2019. Bazuar në evidencën e Statutit dhe rregullores së UET, si edhe bazuar mbi kërkesat ligjore, pranohet se njësia kryesore – fakulteti përmbush detyrimet ligjore përkatëse. <i>(referuar dokumentit numër 2. Statuti i UET)</i> <i>(referuar dokumentit numër 5. Rregullore e UET)</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin	Sipas <i>(dokumentit 6 –Organizimi dhe funksionimi i dekanatit dhe departamentit)</i> paraqiten të gjitha kushtet e organizimit dhe strukturës që lidh departamentin dhe fakultetin, detyrat dhe përgjegjësitë e autoriteteve dhe organeve të tyre drejtuese,

dhe strukturën akademike.	të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet ligjore dhe nënligjore. Sipas dokumentit 23: <i>Të dhëna tabelore për personelin akademik të njësisë kryesore dhe njësisë përgjegjëse</i>, Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit është i përbërë nga tre departamente konkretisht: 1. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, i cili ka; 18 PAE, nga ku 11 me grada/tituj; 2. Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, i cili ka 9 PAE, nga ku 8 me grada/tituj; 3. Qendra për Zhvillimin e Qëndrueshëm, e cila ka 8 PAE, nga ku 4 grada/tituj; Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës për vitin akademik 2018-2019 përbëhet nga 18 staf akademik efektiv (PAE), nga të cilët 8 me titull Profesor, 3 me gradë shkencore Doktor dhe 7 Msc. Departamenti në përputhje me ligjin, është i organizuar në Grup-lëndë. Gjatë vitit aktual akademik 2019-2020, Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës përbëhet nga 13 staf akademik efektiv (PAE), nga të cilët 4 me titull Profesor, 3 me gradë shkencore Doktor dhe 6 Msc. <i>Bie në sy një lëvizje e konsiderueshme e stafit akademik efektiv. Kjo ndikonte në masën e angazhimit në kurrikulën e programit të stafit ekzistues.</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	Njësia bazë përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin e këtij program studimi. Për vitin akademik 2018-2019, departamenti ka në përbërje gjithsej 24 personel akademik, nga ku 18 Personel Akademik Efektiv (PAE), ndër të cilët 3 me titullin Prof. Dr., 5 me titullin Profesor i Asociuar, 3 me gradën Doktor dhe 7 me Msc, dhe 6 personel akademik me kontratë (PAK), nga ku 4 me grada/tituj. (<i>Dokumentit 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të njësisë kryesore dhe njësisë përgjegjëse</i>). Në këtë program studimi, për vitin akademik 2018-2019 janë të aktivizuar në mësimdhënie 7 pedagogë efektivë dhe 2 pedagogë të ftuar. I gjithë stafi mësimdhënës që mbulon këtë program studimi përmbush kriterin e gradës/titullit akademik (4 profesorë të asociuar dhe 3 doktorë), ndërkohë 2 pedagogë (1 efektiv dhe 1 i ftuar) nuk përmbushin kriterin e gradës

	doktor. Pedagogu efektiv është Msc Auditues ligjor, ndërsa pedagogu i ftuar mban titullin ndërkombëtar të profesionistit kontabël ACCA. Gjatë vitit aktual akademik 2019-2020 në këtë program studimi, janë aktivizuar në mësimdhënie 9 pedagogë efektivë dhe 4 pedagogë të ftuar. Staf i mësimdhënës përmbush kriterin e gradës/titullit akademik (6 profesorë dhe 5 doktorë), ndërkohë 2 pedagogë (1 efektiv dhe 1 i ftuar) nuk përmbushin kriterin e gradës doktor. Pedagogu efektiv është Msc Auditues ligjor, ndërsa pedagogu i ftuar mban titullin ndërkombëtar të profesionistit kontabël ACCA. Kjo gjë u vu në pah edhe nga Dekani/Shefi i Departamentit, i cili këmbëngul që ligji duhet të ndryshojë duke ofruar mundësinë që profesionistë të fushës pa tituj apo grada shkencore të përfshihen në mësimdhënie në nivelin Master.
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Njësia kryesore dhe njësia bazë përmbushin të gjitha detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Bie në sy një lëvizje e konsiderueshme e stafit akademik efektiv. Ky ndryshim është i dukshëm jo vetëm në rang pedagogësh që japin mësim në këtë program, por edhe në pozicione drejtuese. Ndryshimi është i dukshëm në stafin e angazhuar për mësimdhënie në këtë program për vitin akademik 2019-2020 kundrejt vitit akademik 2018-2019. Kjo gjë doli në pah edhe gjatë vizitës në institucion ku gjatë diskutimit për problematika në lidhje me kurrikulën, anëtarë të stafit akademik nxirrnin në pah që nuk kishin qenë pjesë e hartimit të kurrikulës, pasi nuk kishin qenë të punësuar pranë këtij institucioni.
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.	Studentët e programit të studimit i zhvillojnë praktikat profesionale kryesisht pranë institucioneve me të cilat UET ka marrëveshje bashkëpunimi (<i>dokumenti 34 dhe 34.1-34.9 në materialet bashkëngjitur nga UET</i>). Çdo studenti i caktohet një pedagog mbikqyrës nga departamenti si dhe një person mbikqyrës nga institucioni ku zhvillon praktikën. Në auditor studentët zhvillojnë 4 seanca me nga 2 orë mësimore.
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili	Bazuar në <i>dokumentin 36 – vendimi për emërimin e koordinatorëve të programit të studimit</i>), Fakulteti i ekonomisë, biznesit dhe zhvillimit me vendim nr. 93 datë 03.12.2018, ka përcaktuar një koordinator për çdo program studimi dhe përkatësisht Prof. Asoc. Hysen Muceku, për

është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	programin MP në Financë me profile. Në këtë dokument përcaktohen detyrat e kordinatorit të programit. Ai është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e kurrikulës së programit dhe praktikave profesionale, për përditësimin e tyre me të rejat e shkencës dhe tregut të punës.			
Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.	Referuar takimit me Koordinatorin e programit gjatë vizitës në institucion, si dhe nga përgjegjësitë e përcaktuar në dokumentin 36, ai shqyrton cilësinë e sylabuseve, miraton temat e eseve dhe detyrave të kursit që propozohen nga pedagogët, si dhe miraton tezat e provimit. Koordinator i ndjek ecurinë e programit të studimit duke raportuar periodikisht tek drejtuesi i njësisë bazë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Bazuar në diskutimet e kryera me pedagogët e programit të studimit gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se në përgjithësi informacionet për elementët e rëndësishëm të programeve të studimeve janë publike dhe të mundshme për t'u aksesuar lirisht. Linja e informacionit lëviz sipas hierarkisë, duke marrë si input dokumentat kryesore në nivel Institucional, ku përfshihen, ligje, vendime, udhëzime rregullore, statuti, të cilat vijnë të protokolluara dhe sipas afateve nga rektorati, përcillen në dekanat, i cili realizon detyrat e tij, miraton rregulloret përkatëse dhe përcjell informacionin mbi vendimet dhe vlerësimet në të dy drejtimet. (<i>Dokumenti 2 statuti UET dhe Dokumenti 5 rregullorja UET</i>). Njësia kryesore dhe veçanërisht njësia bazë përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin dhe strukturën e programeve të studimit. Ata njohin detyrimet ligjore si dhe statutin dhe rregulloren e UET të hartuara në kuadër të ndërdisiplinarizimit të Institucionit (<i>dokumenti 2 dhe 5</i>).

	<i>bashkëngjitur nga UET). Ndërkohë ky informacion është i njohur edhe për stafin e departamentit që përcakton edhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</i>
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Bazuar mbi synimet dhe objektivat e programit të studimit, të cilat paraqiten në <i>dokumentin 7 pika 3.3</i> , i jepet rëndësi formimit të duhur sipas lëndëve të kategorizuara sipas legjislacionit në fuqi, por edhe profileve që bazohen në ndërtimin e kapaciteteve praktike të studentëve në fusha specifike. Ky program është i organizuar në 7 lëndë, 1 praktikë profesionale dhe në përfundim një punim diplome apo provim i përgjithshëm formimi. Lloji i kategorisë së lëndëve dhe kreditet për çdo lëndë janë konform ligjit, siç është përmendur edhe në kriterin 6 të standartit II.1. Raporti i moduleve e aktiviteteve formuese si edhe atyre praktike është në përputhje me bazën ligjore në fuqi, vendimet dhe udhëzimet (<i>dokumenti 14 kurrikula e programit</i>).
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi i studimit MP në Financë me profile, bazohet në sistemin e vlerësimit me kredite ECTS, sistem i cili është pranuar gjerësisht në nivel European dhe në nivel kombëtar, duke krijuar mundësinë e krahasimit të ngarkesës së nevojshme për realizimin e një programi studimi dhe secilës lëndë. Numri prej 6 krediteve për secilën lëndë, dhe bazuar mbi përqindjet për secilin grup/kategori lëndësh duke u bazuar tek lloji i disiplinës, paraqet gjithashtu një kornizë të krahasimit të moduleve dhe i krijon mundësinë studentit të kuptojë ngarkesën dhe punën e tij semestrale dhe vjetore. Ky program studim zgjat 1 vit akademik, i ndarë në 2 semestra dhe ka në total 60 ECTS, nga 30 ECTS për çdo semestër. Secila prej lëndëve është e vlerësuar sipas sistemit vendas e evropian duke u njehsuar në ECTS. Lëndët dhe shpërndarja e tyre me kreditet, orët mësimore në auditor dhe jashtë auditorit, që zënë modulet e kategorive të ndryshme janë në zbatim të vendimit nr 41 dt 24.01.2018, udhëzimeve të MASR dhe rregulloreve të institucionit dhe programit. (<i>dokumenti 14 kurrikula e programit të studimit MP në Financë</i>) (<i>dokumenti 14.1 Plani mësimor i programit MP Financë</i>)
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë	Në planin mësimor të këtij programi studimi janë të përcaktuar qartësisht ngarkesa totale mësimore për çdo lëndë, kreditet përkatëse, orët në auditor dhe jashtë auditorit, që konkludojnë në 750 orë për secilin semestër, pra në një

auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	total prej 1500 orë për të gjithë programin e studimit. Në rregulloren e programit të studimit (<i>dokumenti 7 bashkëngjitur nga UET</i>), e cila gjendet edhe në sistemin LMS ku kanë akses si pedagogët, ashtu edhe studentët përcaktohet mënyra e vlerësimit të dijeve si dhe frekuentimi në masën 80% të orëve në auditor.
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Informacionet për studentët lidhur me programin e studimit janë të paraqitura në Web-site të UET, dhe jepen në rregulloren e programit kriteret e pranimit të studentëve informacion mbi transferimet, ndërprerjen e studimeve apo se si ekuivalentohen studimet (<i>Pika 2, pika 5, pika 9</i>). Sa i përket pranimeve, transferimeve dhe ekuivalentimit sqarohet në rregullore me qartësi se cilat procedura do të duhet të ndjekë studenti, cilat janë rastet përjashtimore, si do të ekuivalentohen programet dhe vlerësohet performanca në institucionin nga vjen. Gjithashtu dokumentat strategjike statuti dhe strategjia e UET japin informacionin e përgjithshëm mbi studentët duke i udhëzuar ata përgjatë periudhës së studimeve. Megjithatë sipas rregullores në çdo rast studenti duhet të ndjekë në UET së paku një vit akademik.
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabusët e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Për të gjitha lëndët e programeve të studimit paraqitet një syllabus i detajuar, i cili kontrollohet dhe miratohet nga përgjegjësi i grup lëndëve dhe nga përgjegjësi i departamentit. Në syllabusin e çdo lënde ofrohet informacion për pedagogët që do të zhvillojnë lëndën, titujt që zotërojnë dhe adresat e emailit, ngarkesa e ndarë në leksione dhe seminare, numri i krediteve, programi ku zhvillohet lënda, tipologjia, kodi dhe nëse lënda është e detyrueshme apo me zgjedhje. Në brendi të tij, çdo syllabus ofron përmbledhjen dhe qëllimin e kursit që do të realizohet si dhe objektivin kryesor të shoqëruar nga termit kyç. Informacioni që ofrohet në këtë pjesë u jep mundësinë studentëve dhe gjithë të interesuarve për të kuptuar fokusin kryesor të lëndës, duke evidentuar që në fillim të lëndës pritjet e tyre prej saj. Programi përmban temat që do të zhvillohen në çdo orë mësimi, si dhe literaturën e detyrueshme dhe literaturën e rekomanduar për çdo temë. Kjo u jep mundësi studentëve që të konsultojnë literaturën e nevojshme për ezaurimin e koncepteve kyç në çdo temë. Duhet theksuar që literatura është koherente (kryesisht e 5 viteve të fundit). Në çdo syllabus janë të përcaktuar të gjithë elementët që kërkohen

	nga Shtojca Nr. 2 e VKM Nr. 41, datë 24.01.2008 "Për elementët e programeve të studimit", si dhe të rregullores së UET.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Programet përmirësohen dhe përditësohen në fillim të çdo viti akademik, jo vetëm duke ofruar ribotimet e literaturës që përdoret në auditor, por edhe duke evidentuar sugjerimet që vijnë nga studentët dhe veçanërisht nga Bordet e Tregut të Punës, të cilat reflektojnë edhe kërkesat e tregut të punës. Duke qenë se në rregullore të UET është përcaktuar që literatura nuk duhet të jetë më e vjetër se 5 vjet, kjo indirekt ndikon në përshtatje dhe përditësim kurrikule.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Referuar ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me nenin 75, pika 6: - Institucioni ka konceptuar këtë program studimi me kohështirje akademike 1 vjeçare, të ndarë në dy semestra; - Vlerësimi i lëndëve, praktikës profesionale dhe punimit përmbyllës së studimeve janë vlerësuar me ECTS, në përputhje me peshën që i takon çdo grup lëndësh sipas tipologjisë së tyre, në një total prej 60 kredite;
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive, zhvillimi i praktikave profesionale si dhe finalizimi me një temë diplome apo një provim në trajtë rast studimi, kanë në fokus thellimin e njohurive dhe aftësive të studentëve. Megjithatë rezervatona qëndrojnë për dy profile: "Administrim Publik" dhe "Manaxhim dhe Vlerësim Projektesh", pasi nuk mendojmë që mbasi studentët marrin tre lëndë të disiplinës shkencore në Financë, arrijnë të specializohen mjaftueshëm si në Financë

	edhe në Manaxhim. <i>Në funksion të thellimit të njohurive dhe aftësive të profilizuara të studentëve sugjerojmë shkurtimin e lëndëve në trung (maksimumi 2) dhe shtimin e lëndëve të karakterit profesional (1-2 lëndë në profile).</i> Gjithashtu mendojmë që lënda e “Teorive Financiare” është disiplinë shumë shkencore dhe e një niveli të lartë vështirësie për studentë të masterit profesional. Sugjerojmë që kjo lëndë nuk duhet të jetë pjesë e kurrikulës së këtij programi. Për këtë sugjerim ranë dakort edhe përgjegjësi i departamentit dhe pedagogët, të cilët kanë në plan që pasi të kalojnë procedurën e akreditimit ta heqin dhe ta zëvendësojnë me lëndë tjetër. Ndërkohë në masterin me profil “Auditim dhe Manaxhim Risku” nuk ka asnjë lëndë në fushën e manaxhimit të riskut. Sugjerojmë që në këtë profil të shtohen 1-2 lëndë në fushën e manaxhimit të riskut. Përgjegjësi i departamentit dhe pedagogët ranë dakort me vërejtjen tonë.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të nxëniet dhe aftësimit profesional.	Shpërndarja e lëndëve në semestra, si dhe vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave të programit të studimit për të profilizuar studentët, duke iu ofruar këtyre të fundit si aftësim teorik në fushën e financës, ashtu edhe profesional për atë çfarë kërkon tregu. Ndërkohë edhe për këtë kriter qëndrojnë rezervat e shprehura në kriterin e mësipërm. Të gjitha lëndët kanë një numër të barabartë kreditesh dhe si rrjedhim një kërkesë për punë të njëjtë për orët në auditor dhe jashtë tij si punë të pavarur të studentit. Kjo shpërndarje e ngarkesës, pak a shumë uniforme, krijon mundësi për njëgjashmëri me programe të tjera studimi.
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e këtij programi, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit në fushën e financës, kontabilitetit dhe auditimit. Ndërkohë lënda “Teori Financiare” është disiplinë shumë shkencore e përshtatshme për master shkencor. <i>Nuk mendojmë që struktura dhe lëndët janë të përshtatshme për profilet në fushën e manaxhimit, pavarësisht se nga stafi na u argumentua që gjithçka është në kuadër të fokusit të UET për ndërdisiplinarizim.</i> Një problem tjetër që evidentojmë është fakti që lëndët që zhvillohen në këtë program zhvillohen pothuaj të gjitha në

	master shkencor. Për më tepër sylabuset e tyre janë identike. Nuk na duket me vend që të gjitha lëndët të zhvillohen në të njëjtën mënyrë si për masterin shkencor, edhe për masterin profesional kur këto mastera kanë fokus të ndryshëm (shkencor kundrejt profesional). Mund të justifikojmë që 1-2 lëndë të kenë të njëjtin sylabus, por jo të gjitha. Këto lëndë zhvillohen bashkarisht në auditor (me studentë të disa masterave shkencorë e profesionalë) gjë që gjykojmë ul efikasitetin e lëndës, pasi një lëndë (e karakterit profesional ose jo) duhet trajtuar ndryshe për studentë të degëve të ndryshme, dhe veçanërisht për studentë që ndjekin një master shkencor kundrejt atyre që ndjekin master profesional. Për shembull, analiza e research papers që ofrohen si literaturë e rekomanduar, duhet të ketë fokus të ndryshëm trajtimi për studentë të masterit shkencor dhe profesional. Literatura kryesore dhe vecanërisht ajo e rekomanduar duhet të jetë e ndryshme në tema të veçanta, në varësi të asaj se çfarë është e rëndësishme të trajtohet me secilin grup studentësh. <i>Sugjerojmë që sylabuset të përshtaten për secilin program studimi dhe lëndët të zhvillohen në mënyrë të ndarë për masterin shkencor dhe profesional.</i> <i>Gjithashtu duhet të ulet numri i lëndëve të disiplinës shkencore në master profesional dhe të rritet ai i disiplinës profesionale (sugjeruar edhe më lart).</i>
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Si në kriterin e mësipërm mendojmë që ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve, për profilizim në fushën e financës, kontabilitetit dhe auditimit. Studentët që mbarojnë Masterin Profesional në Financë, shohin mundësinë e transferimit në Masterin Shkencor në Financë. Fakti që pothuaj të gjitha lëndët e Masterit Profesional në Financë janë pjesë e kurrikulës së Masterit Shkencor në Financë, e bën shumë të lehtë këtë tranferim (për vitin 2018-2019, 22 studentë nga 102 studentë pra janë transferuar 21,6% e studentëve)
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Pedagogët mundohen që sylabuset e lëndëve të përditësohen me literaturë të 5 viteve të fundit. Kjo ishte e përcaktuar edhe në rregulloren e UET. Ndërkohë nga biseda me përfaqësues të SBCS na u komentua: kur kjo është e mundur. Në përgjithësi të gjithë sylabuset kishin literaturë të detyruar dhe ndihmëse të

	5 viteve të fundit, me përjashtime të vogla. Gjithashtu, pedagogët e lëndës ofrojnë si literaturë ndihmëse punime të tyre në këtë fushë (kur kanë punime të fushës).			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.	Lëndët që zhvillohen në këtë program studimi, si dhe sylabuset përkatës iu ofrojnë studentëve mundësinë e përfitimit të dijeve, aftësive dhe kompetencave që nevojiten për një program Master Profesional. Sigurisht që këtu duhet të konsiderohen sugjerimet në kriteret 2,3,4 të këtij standarti.			
Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Organizimi i programit të studimit, duke ofruar gjatë semestrit të parë lëndë kryesisht të kategorisë A dhe B, ndërsa gjatë semestrit të dytë lëndë kryesisht të karakterit profesional ndikojnë në një formim të mirë profesional të studentëve. Zhvillimi i praktikës kryesisht pranë industrisë, thellon profesionalizmin e studentëve duke i bërë ata më të aftë për tregun e punës.			
Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e këtij program studimi, ku në përditësimin e sylabuseve është marrë në konsideratë krahas opinionit të pedagogëve, edhe opinionin e Bordit të Tregut të Punës, ndikon pozitivisht në punësimin e studentëve, pasi është konsideruar ajo çfarë kërkohet nga tregu i punës. Këtu vlejnë sërish rezervat e shprehura më lart në lidhje me përmbajtjen e këtij program studimi. Studentëve të këtij masteri iu mundësohet vazhdimi i Masterit Shkencor në Financë. 21,6% e studentëve kanë vazhduar studimet në Masterin Shkencor në Financë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat	Bazuar në Ligjin 80/2015, personeli akademik me kohë të plotë dhe ai me kohë të pjesshme kryen veprimtari të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbime në mbështetje dhe zhvillim të institucionit, këshillime për studentët etj.

ligjore në fuqi.	Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme që angazhohet në mësimdhënie në këtë program studimi ka titujt dhe gradat sipas legjislacionit në fuqi, përveç dy rasteve: një pedagog efektiv me Msc Auditues Ligjor, dhe një pedagog joefektiv me certifikatë ndërkombëtare profesionale ACCA. Nga të dhënat që morëm gjatë vizitës në institucion rezultoi se për vitin akademik, 2019-2020, për këtë program studimi janë angazhuar në mësimdhënie gjithsej 13 personel akademik nga ku 9 personel akademik efektiv (PAE), nga ku: 2 me titullin Prof. Dr, 3 me titullin Prof. Asoc, 3 me graden Dr/PhD dhe 1 me Msc dhe 4 personel akademik me kontratë (PAK), nga ku: 1 me titullin Prof. Asoc, 2 me graden Dr dhe 1 certifikatë ndërkombëtare profesionale ACCA. Pra raporti PAE/PAK për këtë vit akademik është 9/4. Mbulimi i programit në përqindje është 70% PAE.
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Personeli akademik që angazhohet në këtë program studimi ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për të realizuar lëndët në këtë master. Numri dhe kualifikimi i stafit të angazhuar në këtë program studimi, për dy vite akademike është si më poshtë: Për vitin akademik 2018-2019 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ishte 15 pedagogë gjithsej, nga ku 13 personel akademik efektiv (PAE), 12 me tituj/grada. <i>(Sipas dokumentit 24, të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit).</i> Mbulimi i programit në përqindje është 86.6% PAE, 13.4% PAK. Për vitin akademik 2019-2020 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është 13 pedagogë gjithsej, nga ku 9 personel akademik efektiv (PAE), 8 me tituj/grada. <i>(Sipas dokumentit: Stafi akademik i programit MP Finance 2019-2020, kërkuar gjatë vizitës).</i> Mbulimi i programit në përqindje është 70% PAE dhe 13.4% PAK. Referuar dokumentit të kërkuar gjatë vizitës në institucion <i>(Stafi akademik i programit MP Finance 2019-20)</i>, rezulton se ngarkesa e orëve në auditor e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi është: 720 orë mbulohen nga PAE dhe 240 orë mbulohen nga PAK.

	Referuar dokumentit (25. Të dhëna me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik - MP Financë), rezulton se ngarkesa e stafit akademik të këtij program studimi edhe në programe të tjera të ofruara nga UET, varion nga 78.75 orë (PAK) deri në 266 orë (PAE).
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Përcaktimi i ngarkesave për stafin akademik është bërë në përputhje të kualifikimit të secilit anëtar të stafit me përmbajtjen e programit dhe specifikën e lëndëve. Nga takimet e zhvilluara me pedagogë gjatë vizitës në institucion dhe nga konsultimi i CV-ve bashkëngjitur nga UET, rezulton se fusha e kërkimit të pedagogëve efektiv dhe joefektiv përkon me programin e studimit dhe lëndëve të tij.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	UET ka nënshkruar një sërë marrëveshesh me Institucione të tjera të Arsimit, Institucione Publike por një rol të rëndësishëm luajnë marrëveshjet me Industrinë. Për çdo student, gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës caktohet një pedagog drejtues dhe një person mbikqyrës nga institucioni ku studenti zhvillon praktikën, duke i dhënë mundësi këtij të fundit për konsulencë dhe ekspertizë si gjatë realizimit të praktikës, ashtu edhe në punimin final për përmbylljen me sukses të këtyre studimeve. Personeli përgjegjës për praktikën profesionale, është personel i departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, dhe të këtij programi studimi. Për provimin e praktikës organizohet komisioni i praktikës profesionale. Janë 19 subjekte me të cilat ka marrëveshje, ku janë realizuar praktikat mësimore të studentëve të programit të studimit. (<i>Dokumenti 34. MP FINANCE - Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>). Procesi i praktikave pasqyrohet në evidencën 32.2 (<i>Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale. pika B.I.7</i>), dhe është një bashkëveprim midis koordinators të departamentit, pedagogut përgjegjës dhe studentit, ku secili ka përgjegjësitë e tij. Në përfundim të studimeve realizohet punimi i diplomës, ku vendoset në dispozicion personeli akademik udhëheqës i diplomës, brenda departamentit ose dhe nga jashtë departamentit nëse vlerësohet e nevojshme, sigurisht me titujt dhe kualifikimet përkatëse. Drejtues të Institucioneve me të cilët ka marrëveshje UET, zhvillojnë rregullisht leksione të hapura për studentët, duke bërë që këta të fundit të jenë më pranë realitetit ekonomik dhe profesionit të tyre.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit	Ky program studimi në kurrikul nuk ka të programuara orë

të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	laboratorike, megjithatë UET në infrastrukturën e tij ofron laboratore të cilat mund të përdoren nëse do të gjykohej nga pedagogët në të ardhmen. <i>Lëndë si "Metoda Kërkimi të Avancuara" dhe "Analizë dhe Raportim Financiar" mund të konsiderojnë shtim të orëve në laborator.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Suk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Sipas statutit të UET (<i>neni 30, pika 30.4</i>) parashikohet se çdo program studimi konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me Bordet e Tregut të Punës të ngritur në nivel departamenti, i cili ka në fokus përmirësimin e kurrikulave të këtij programi studimi. Ata konsiderojnë me një rëndësi shumë të madhe opinionin e anëtarëve të Bordit të Tregut të Punës, të cilët minimalisht mbledhen 2 herë në vit. Gjithashtu vlerësojnë opinionin e partnerëve të tyre nga Industria. Në leksionet e hapura që zhvillohen prej drejtuesve të këtyre institucioneve, dalin në pah edhe nevojat e tregut të punës, si dhe njohurive që kërkohen.
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Departamenti ka në fokus përmirësimin e kurrikulave të këtij programi studimi. Studentët janë të ftuar në mbledhjen mujore të departamentit, duke iu dhënë mundësinë që ata të shprehin opinionet e tyre për të përshtatur programin e studimit sa më mirë me tregun e punës. Duhet të konsiderojmë faktin që shumica e këtyre studentëve janë të punësuar, kështu që opinionin e tyre bëhet akoma edhe më i vlefshëm, duke qenë se vjen nga eksperiencia dhe tregu i punës. Studentët janë pjesë e rrjetit ALUMNI, gjë që rrit më shumë bashkëpunimin ndërmjet tyre, duke ndarë informacione dhe opinione me njëri tjetrin.

Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Krijimi i rrjetit ALUMNI dhe i Bordit të Tregut të Punës (që përbëhet nga ish studentë të ALUMNI) kanë pasur si qëllim krijimin e urave të forta lidhëse ndërmjet institucionit dhe studentëve. Këto rrjete i japin mundësi institucionit që edhe pas përfundimit të studimeve të kenë mundësi të konsultohen me ish studentë për të përmirësuar programin e studimit. ALUMNI përfshihet në hartimin e strategjisë së Institucionit si dhe në përmirësimin e kurrikulave dhe lëndëve të programit.			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	Marrëveshjet e bashkëpunimit që ka UET me institucione publike dhe private, i kanë dhënë mundësi të reflektojë nevojat e tregut të punës në programet e tij të studimit. Duke konsideruar nevojat në rritje të tregut (një treg në zhvillim) në sektorin bankar, kontabilitet, analize financiare, auditim (zgjerim i tregut të kompanive të auditimit në Shqipëri), manaxhimit të projekteve dhe sektori publik, është përshtatur kurrikula e programit me specialitetet përkatëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve,	UET në rregulloren e tij ka parashikur metodat e ndërtimit të programit të lëndës, përshtatur me fushën e studimit (<i>referuar dokumenti numër 5 Rregullore e UET dhe numër 39 Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës</i>). Procesi mësimor zhvillohet me leksione, seminare, leksion/seminare, punë laboratorike, praktika mësimore, detyra praktike, detyra kursi, provime të ndërmjetme,

lëndëve/moduleve.	provime përfundimtare, praktika profesionale dhe me punim diplome. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se njësia përgjegjëse e programit të studimit në bashkëpunim me SBC kujdeset për monitorimin e procesit mësimor dhe garantimin e mësimdhënies cilësore duke marrë veprime konkrete përmirësuese në nivelin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjithashtu përveç rregulloreve, institucioni zhvillon një proces të gjerë të kontrollit dhe përmirësimit të metodave të mësimdhënies. Kontrolli bëhet nga struktura të ndryshme të institucionit. Gjithashtu stafi trajnohet si brenda institucionit, edhe jashtë në universitete ku kryejnë specializime të ndryshme.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Metodat e kontrollit të cilësisë së mësimdhënies së stafit akademik janë shumë të zhvilluara dhe në disa nivele. Kështu monitorimi bëhet përmes pyetësorëve të studentëve. Gjithashtu studentët me mesatare mbi notën 8 organizohen në fokus grupe, rezultatet e të cilave i jepen fillimisht vetëm shefit të departamentit. Këto fokus grupe, sipas mendimit të drejtuesve rezultojnë shume efektive. Gjithashtu çdo pedagog i ri apo që jep një lëndë të re kontrollohet nga përgjegjësi i departamentit ose përgjegjësi i gruplëndës. Dhe çdo dy vjet bëhet vlerësim dhe nga rektori dhe administratori.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Në procesin e monitorimit të cilësisë së mësimdhënies, UET i jep kryesisht zë studentëve përmes shprehjes së mendimit për secilin pedagog në pyetësorë, përmes fokus grupeve, përmes pjesëmarrjes një herë në muaj të studentëve në mbledhjet e hapura të departamentit, si dhe përfaqësimit në Senat dhe në KSBC. Pyetësorët hartohen nga KSBC dhe synojnë mbledhjen e opinionit të studentëve lidhur me procesin e mësimin dhe çdo dukuri tjetër të lidhur me të. Ky proces ndodh dy here në vit, në përfundim të semestrit dhe përpara sezonit të provimeve për të evituar ndikimin në vlerësim. Rezultatet e anketimit janë pjesë e analizës vjetore të njësisë kryesore së bashku me intervistat e zbardhura të fokus grupeve periodike.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) u vë në dispozicion rezultatet e vlerësimit përgjegjësve të departamenteve, të cilët më tej ua komunikojnë individualisht stafit akademik. Rezultatet e tyre diskutohen në mbledhjet e departamentit dhe shoqërohen me marrjen e masave korrigjuese.

Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Institucioni ka disa mekanizma aktivë, ku përfshihet edhe KSBC që realizon procesin e vlerësimit. Referuar RVB, të dhënat e marra nga këto mekanizma shërbejnë për identifikimin e problematikave me synim marrjen e masave për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë së brendshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë të përcaktuara qartë në rregulloren e UET. Përveç tyre, UET nxit dhe zhvillimin e panairove dhe open weeks, ku studentët marrin njohuri mbi mundësitë për punësim dhe zhvillim të mëtejshëm karriere. Gjithashtu zhvillohen dhe orë të hapura me tema të vecanta sipas specifikave të lëndës dhe specialistëve të ftuar. Kjo ndodh shpesh dhe përbën tashmë praktikë në masterat në fushën e Financës. Referuar dokumentit 14.1 (<i>Plani mesimor i programit MP Financë</i>) orët në auditor rezultojnë: - Leksione 316 orë; - Seminare 122 orë; - Ushtrime/projekte/detyra 126 orë; - Praktikë profesionale 120 orë; - Punim diplome 28 orë;
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në	Gjatë vizitës me stafin, u konstatua një disponibilitet i tyre për të ndihmuar studentët që mund të kenë vështirësi për arsye të ndryshme. Gjithashtu ata janë disponibël që të zhvillojnë me orë ekstra të përqëndruara për studentët e huaj që vijnë të ndjekin kurse të caktuara në kuadër të projektit Erasmus+. Gjithashtu studentë që nuk mund të frekuentojnë një lëndë të caktuar gjatë vitit, për të mos e humbur fare mundësinë e dhënies së provimit, mund ta zhvillojnë në sezonin e vjeshtës me orë të përqëndruara, kundrejt pagesës dhe më pas të shlyejnë detyrimin e provimit. Siç u pohua dhe

veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	nga takimi me studentët, pedagogët janë të gatshëm të përgjigjen dhe asistojnë studentët për çdo paqartësi.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	UET trajnon pedagogët e jashtëm e të brendshëm mbi specifikat e rregullores së UET, metodat didaktike të mësimdhënies dhe organizimin e punës akademike e shkencore. Pjesë e rëndësishme e trajnimeve është përdorimi i sistemit të brendshëm të komunikimit me studentët, LMS, për sigurimin e çdo materiali teorik lidhur me përmbajtjen e lëndës, detyrat e kursit dhe vlerësimet. Këto kapacitete janë në avantazh të personelit akademik për të krijuar një mjedis më të mirë për transferimin e dijeve tek studentët.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Personeli akademik i përfshirë në programin e studimit MP Financë me profile përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Stafi akademik është me grada/tituj, në përputhje me ciklin e studimit ku japin mësim. Fusha kërkimore shkencore e personelit akademik është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve të tyre të mësimdhënies.
Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Një prej faktorëve kryesorë që ndikojnë në metodat e mësimdhënies në UET janë studentët. Por në vizitat e zhvilluara në institucion, gjatë takimit me studentët, prania e tyre ishte e vogël (vetëm 3 studentë) për të kuptuar qasjen e studentëve përfaqësues të këtij program studimi. Përveç kësaj, për të marrë një feedback më të saktë dhe të plotë, mund të ishin të pranishëm studentë që kishin ndjekur studimet në vitin akademik 2018-2019.
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	Zhvillimi i leksioneve dhe seminareve në formë të pandarë, shoqëruar me raste praktike studimi, i bën më tërheqëse dhe lehtëson orët e mësimi për studentët. Ndër metodat inovative për përmirësimin e procesit mësimor përfshihet Moodle-aplikacion LMS (Learning Management System), i cili mundëson menaxhimin e materialeve mësimore dhe procesit mësimor me krijimin e web faqeve dinamike për studentët dhe pedagogët.
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e	Në përputhje me misionin e institucionit dhe synimin për të përmirësuar mësimdhënien, cilësia e mësimdhënies është objektivi kryesor që kërkon përpjekjet dhe përkushtimin e të gjithë institucionit, përfshirë jo vetëm personelin akademik, por edhe atë administrativ. Autonomia e studentit konsiston

marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	në: zhvillimin e seminareve në mënyrë interaktive duke përfshirë dhe raste studimi, zhvillimi i detyrave të kursit në grupe të vogla me 2-3 studentë, zhvillimi i praktikave profesionale dhe i temave të diplomës në mënyrë të pavarur, të mbikqyrur gjatë gjithë kohës nga pedagogu i lëndës, udhëheqësi i diplomës dhe praktikës, koordinatori i programit dhe zyra e këshillimit të karrierës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Procesi mësimor i programi MP Financë me profile zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë. Këto ambiente janë të ndara në dy godina kryesore: Godina A është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m ² dhe Godina B është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m ² . Të dy godinat janë të ndara në: salla leksionesh, ku të gjitha klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme. Gjithashtu studentët kanë në dispozicion bibliotekën 300m ² , dhe laboratorë mësimorë e informatike. Mjediset universitare janë të mbuluara me sinjal WiFi, i cili ndihmon në procesin mësimor. Stafi i IT-së ishte i angazhuar për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe pajisjeve ndihmëse në auditore, në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit të mësimi.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	Institucioni ofron për këtë program studimi ambiente funksionale për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, si dhe laboratoreve atëhere kur zhvillohen orë laboratorike. Sallat janë të pajisura me mjetet e nevojshme për zhvillimin e mësimi, si PC, projektorë dhe foni. Në funksion të studentëve është vënë dhe biblioteka e cila ka kapacitetin e duhur si dhe literaturën e nevojshme dhe që ndihmon. Aksesimi në literaturën online bëhet përmes kompiuterave. Një staf i specializuar asiston gjatë gjithë kohës studentët dhe i nxit ata në përdorimin e informacionit.

Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Sistemi IT ndihmon gjatë gjithë procesit mësimor studentët dhe pedagogët për të siguruar informacionin e nevojshëm dhe për të bashkëpunuar me njëri tjetrin. Platfomormë LMS (<i>dokumenti 46 bashkëngjitur</i>) ndihmon veçanërisht në këtë proces për të gjitha materialet e nevojshme dhe të përditësuara. Procesi mësimor mbështetet nga ky sistem, i cili bën të mundur që studenti të informohet nga pedagogu kudo që ndodhet dhe të ndërveprojë me kolegët e kursit online.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Nga analiza e sylabuseve të lëndës, u konstatua që për çdo sylabus kishte literaturë bazë dhe literaturë ndihmëse. Kjo literaturë ishte në dispozicion të studentëve si në formatin fizik në bibliotekë, ashtu dhe në formatin elektronik në sistemin LMS nga pedagogu i lëndës.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka ka gjithsej 150 vende leximi, 12 kompjutera dhe gjithë ambjenti është i mbuluar nga rrjeti wireless. Biblioteka ka krijuar një katalog me libra elektronikë në gjuhë të huaj, i cili ka qindra tituj librash në bazë të programeve të studimit dhe që u vjen në ndihmë edhe studentëve të këtij program studimi. Biblioteka përditësohet me tituj të rinj dhe botime periodike dhe të vetë institucionit, gjë që ndihmon studentët me të rejtat e fundit në fushën e financës në ekonominë e huaja dhe atë vendase.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Biblioteka ka siguruar akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si: Questia, Social Science Library, Sage. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS. Gjithashtu studentët i disponojnë online të gjitha materialet didaktike të nevojshme për studim.
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Nga vizitat në institucion u konstatua që UET kishte infrastrukturën e nevojshme për të realizuar objektivat mësimorë të programit. Studenti mund të punonte për realizimin e detyrimeve lëndore apo të programit, ose në biblioteke ose në sallat e informatikës të cilat ishin të pajisura me software-t e duhur për këtë gjë. Studentët në UET kanë të gjithë bazë laboratorike të nevojshme për të zhvilluar punët laboratorike, esetë dhe diplomat e tyre.
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin	Çdo pedagog në UET komunikon me studentët e tij nëpërmjet UET LMS. Nëpërmjet këtij sistemi pedagogu bën njoftime,

akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	ngarkon sylabusin, prezantimet, leksionet, weblink-e me material shtesë, hedh pikët e çdo vlerësimi për studentët e tij, etj. (dokumenti nr 46 bashkëngjitur). Kjo gjë realizohet sipas urdhërit administrativ për LMS, nr.09, date 02/11/2017 Mbi zbatimin e plotë në procesin mësimor administrativ të platformës UET LMS.			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Komunikimi i brendshëm realizohet si nëpërmjet adresave të email-it të krijuara nga institucioni për stafin akademik, administrativ dhe studentët. Nëpërmjet sistemit LMS, studenti jo vetëm ka disponibilitet të materialeve mësimore të vëna në dispozicion nga pedagogu i lëndës, por njëkohësisht ka akses për notat online, si dhe forume me pedagogë e studentë të tjerë. Secili student ka llogarinë vetjake në këtë sistem.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës sipas fushave të kërkimit që mbulon programi i studimit dhe departamenti. Udhëheqësi zhvillon seanca metodologjike në auditor me grupin e studentëve që udhëheq, për të garantuar shkrimin e punimit në përputhje me standartet e punimit shkencor. Udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e paraqitur nga studenti përpara mbrojtjes.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Njësia KSBC është ajo e cila monitoron të gjithë procesin e mësimdhënies dhe punon me metoda të parashikuara në rregulloret e institucionit për përmirësimin e kësaj cilësie, që nga sylabuset, metodat e mësimdhënies, vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, trajnimit të stafit, vlerësimi i dijeve, etj.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë	Shumë të rëndësishëm paraqiten hallkat e brendshme me në

është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	krye njësinë bazë mbështetëse: Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, por dhe njësi mbështetëse Departamenti i Manaxhimit dhe Marketingut, që plotëson dy profilet e tjera. Në kuadër të rritjes dhe përmirësimit, të performancës akademike-mësimore, këto dy njësi bashkëpunojnë ngushtësisht me KSBC-në për garantimin e cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, të personelit akademik dhe të studentëve. I gjithë stafi është i angazhuar në proces duke rishikuar sylabuset, literaturën, metodat e mësimdhënies të përdorura, korrektësinë në vlerësimin e provimeve, në funksion të përmirësimit të cilësisë. Stafi është nën monitorim nga shefi i departamentit apo i gruplëndës. Stafi përzgjidhet nga një komision i cili ka në përbërjen e tij dhe shefin e departamentit. Edhe ngarkesa mësimore shpërndahet nga shefi në bazë të specializimit të secilit pedagog dhe udhëzimeve në fuqi.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Stafi akademik trajnohet nga njësi e sigurimit të cilësisë për metodat e mësimdhënies, si dhe nxitet për të bërë trajnime në universitete jashtë vendit ku nga shkëmbimi i eksperiencës mund të përfitohet edhe në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Referuar (<i>Dokumentit.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020</i>), në UET prioritet është kërkimi shkencor. Kërkimi shihet si faktor kyç në promovimin e insitucionit dhe programeve të studimit. Stafi akademik është i organizuar në grupe kërkimore të cilat janë pjesë e Qendrës Kërkimore - Shkencore përgjegjëse për kualifikimet në fushën e kërkimit shkencor. Gjithashtu stafi akademik nxitet të botojë në revista të huaja dhe vendase si dhe të marrë pjesë me punime shkencore në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo jo vetëm rrit kërkimin shkencor të pedagogut, por përmirëson dhe literaturën ndihmëse të përdorur prej tij në lëndë.
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Nga vizitat në institucion u vu re një gadishmëri për të qenë gjithmonë vigjilentë për përmirësimin e sylabusit dhe metodave të reja të mësimdhënies.
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik	Në përgjithësi të gjitha përpjekjet e stafit akademik në

testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	funksion të përmirësimit të elementëve të lëndës mirëpriten nga departamenti dhe janë subjekt i diskutimeve në mbledhjet e departamentit. Institucioni ka realizuar zhvillimin e një sërë aktiviteteve me natyrë shkencore të tilla si konferenca, seminare, leksione të hapura me personalitete dhe lektorë të huaj, ku është nxitur pjesëmarrja e personelit akademik.			
Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	Karakteristikë e këtij institucioni dhe objektiv kryesor i tij është kontakti me ekspertët dhe përvojën e tregut. Për këtë arsye, përveç të tjerave, organizohen orë të hapura me lektorë të ftuar, specialistë në fushat përkatëse. Përveç orëve të hapura me tema të veçanta, zhvillohen dhe aktivitete të tjera si panairë të punës, dhe aktivitete të tjera.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive përcaktohen në rregulloren e programit të studimit, pika 5 "Kontrolli dhe vlerësimi i dijeve", si edhe me dokument të veçantë, pjesë e Broshurës së Dokumenteve të posaçme. Këto kritere bëhen publike dhe njihen nga studentët. Mënyrat e kontrollit të dijeve të këtij neni, përcaktohen në programin e modulit dhe planin mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentit në fillim të procesit mësimor nga pedagogu i lëndës (<i>referuar dokumentit numër 7 Rregullore e programit MP Finance</i>).
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të	Format e kontrollit të dijeve dhe pse gjenden në rregulloren e UET, u bëhet e ditur studentëve me sylabusin e lëndës. Sylabuset janë të përcaktuara qartë. Aty vlerësohen format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe

parashikuara në sylabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	praktik të një moduli. Gjithashtu përcaktohen dhe afatet e dorëzimit të detyrimeve. Vlerësimi bëhet në bazë të: • Frekuentimit, prezencave të detyrueshme në veprimtaritë mësimore në auditor; • Kontrolli i vazhdueshëm ku përfshihen: pjesëmarrja aktive në seminare, provimi i ndërmjetëm, detyra e kursit, Ese argumentuese në klasë dhe Provimi përfundimtar; Tezat e provimit hartohen nga titullari i modulit dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Në ndihmë për studentin vjen dhe platforma LMS ku përveç të tjerave vendosen njoftime të detajuara për detyrat dhe provimet në kuadër të lëndës. Gjithashtu një koordinim të punës dhe të njoftimeve të studentit kryen dhe koordinatori i departamentit.			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Duke qenë një program studimi i nivelit të dytë, normalisht duhet të shtohet puna e pavarur dhe në grup e studentit. Prandaj diversifikohen dhe mënyrat e vlerësimit. Studenti vlerësohet me shkrim dhe me anë të një eseje. Puna me shkrim është në formën e dy testeve: një të ndërmjetëm dhe një përfundimtar, pra jo në formën e një provimi të vetëm. Kjo lehtëson asimilimin e dijeve gjatë semestrit. Gjithashtu një vend të rëndësishëm zë dhe eseja e cila zhvillohet në grupe 2-3 studentë, dhe ka qëllim nxitjen e punës së studentit në grup. Vlerësim të veçantë zë dhe aktivizimi i studentit gjatë mësimit, formë kjo për të motivuar më shumë studentin për t'u përgatitur më shumë gjatë vitit. Gjithashtu në këtë program studimi një lëndë të veçantë zë praktika profesionale, e cila nxjerr në pah dhe zhvillon më tej aftësitë profesionale të studentit në fushën përkatëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	Vlerësimi i studentëve është i vazhduar dhe i shtrirë në kohë gjatë gjithë semestrit dhe i ndarë në komponentë të

profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	rëndësishëm që nxit më shumë studentët të marrin pjesë në mësim me esetë e tyre dhe angazhimin e tyre në mësim. Vlerësimi jepet gjatë të gjithë procesit mësimor e finalizohet në fund të vitit me notën përfundimtare. Vlerësimi gjatë vitit dhe vlerësimi përfundimtar gjenden në formë elektronike përmes sistemit LMS. Gjithashtu rezultatet e studentit dokumentohen në dokumenta si regjistri i pedagogut dhe pasqyra e vlerësimit dhe depozitohen në Sekretarinë Mësimore.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Testimi dhe vlerësimi i studentëve është një proces, të cilit i kushtohet rëndësi në këtë institucion. Këto metoda standartizohen deri në një masë të catuar nga institucioni me qëllim shmangien e abuzimeve dhe rritjen e transparencës, duke ruajtur lirinë akademike. Megjithatë përveç kësaj, nga institucioni vendosen njësi të veçanta, si KSBC, e cila kryen procesin e rishikimit të vlerësimeve. Në rast të gjetjes së diferencave të thella midis korigjimit korrekt dhe atij aktual, pedagogu duhet të shpjegojë arsyet e këtij vlerësimi. Gjithashtu ka filluar të përdoret dhe sistemi i vlerësimit elektronik "Clean Scoring" në kuadër të bashkëpunimit midis UET dhe AADF, i cili shmang totalisht subjektivizmin në vlerësim. Gjithsesi një sistem i tillë mund të përdoret pjesërisht dhe për lëndë të caktuara.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Në rastin e lëndëve të programit, është në gjykimin e titullarit nëse korigjimin do e bëjë i vetëm, apo në bashkëpunim me pedagogët asistentë. Nëse studenti kërkon të rishikojë provimin dhe shfaq pakënaqësi dhe nuk bindet nga pedagogu i lëndës, atëherë ngrihet një komision tjetër që e rikorigjon. Vlerësimi me komision është i detyrueshëm vetëm për praktikën profesionale dhe punimin e diplomës apo provimin e përgjithshëm përfundimtar.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Konfirmuar edhe nga Rregullorja e Programit të studimit dhe takimit me KSBC gjatë vizitës në institucion, të gjitha format e testimit me shkrim si të vazhduar ashtu dhe përfundimtare zhvillohen duke mbajtur anonim emrin e studentit, nëpërmjet procesit të sekretimit.
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është	Studenti, ashtu siç parashikohet dhe në rregulloret përkatëse, ka të gjitha të drejtat të qartësohet në lidhje me vlerësimin e vazhduar dhe atë final, të kryer nga pedagogu i lëndës.

i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Studentët e MP Financë në të gjitha lëndët zhvillojnë detyra kursi dhe raste studimore. Gjatë zhvillimit të tyre dhe në mbrojtjen e tyre, studentët marrin këshilla dhe vlerësim nga pedagogu lidhur me aspektet pozitive dhe negative dhe çfarë duhet të përmirësojnë. Ky proces ndihmon studentët të përmirësohen në aspekte të mësimnxënies dhe të ballafaqimit me audiencën. Referuar RVB në funksion të sqarimit të studentit janë edhe seancat sqaruese, ku ata mund të marrin komente të detajuara mbi vlerësimin.
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Nga takimet me stafin akademik, u vu re një rritje e ndërgjegjësimit të evitimit të plagjiaturave edhe në ese. Institucioni përmes një sistemi anti-plagjiaturë, ka të ruajtura në sistem të gjitha punimet e studentëve të të gjitha niveleve të studimit në UET. Kështu që është lehtësisht e kontrollueshme plagjatura të paktën nga materialet e prodhuara nga puna kërkimore dhe shkencore në këtë institucion. Gjithashtu edhe procesi i provimit ka një procedurë të caktuar të ruajtjes në provim dhe të procesit të sekretimit.
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në rregulloren e UET është i përcaktuar qartë dorëzimi i rezultateve të provimeve të sezonit normal dhe të sezonit të vjeshtës. Vlerësimi gjatë vitit si dhe pikët e provimit final nuk mund të ndryshohen pa dhënë një shpjegim të qartë nga pedagogu i lëndës. Përmes sistemit online MOODLE UET LMS, studenti informohet brënda afateve të përcaktuara nga institucioni për rezultatet e provimit.
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Referuar (pikes 5.8 të rregullores së programit të studimit) janë pasqyruar kushtet dhe procedurat për rishikimin e vlerësimit. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. I kushtohet mjaft rëndësi informimit të studentit për çdo hap të vlerësimit që ka lidhje me provimet dhe rezultatet përkatëse.
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Sipas pikes 5.8 të rregullores, studenti ka të drejtë të ankimojë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës. Ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ngre një komision me 3 anëtarë, i cili bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shumicë të

	thjeshtë. Vlerësimi i Komisionit është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit MP në Financë me 5 profile, është i konceptuar me 60 kredite, ku 4 lëndë janë të përbashkëta dhe lidhen kryesisht me lëndë që thellojnë teorinë financiare (filozofi thuajse e njëjtë edhe me Msc në Financë) në tregjet dhe institucionet financiare, si dhe metoda të thelluara të kërkimit, dhe profilizimi në 5 profile realizohet me 3 lëndë që mendohet të realizojnë profilizimin përkatës. Nga takimet me stafin dhe njësitë e tjera të UET u theksua që ky profilizim ka qenë politikë e përgjithshme e institucionit, me qëllim ofrimin e një game sa më të gjerë diplomash dhe manaxhimit eficient të portofolit të lëndëve. Por brenda qëllimit të kësaj politike, sërish ka vend për përmirësim të kurrikulës, gjë e pranuar dhe nga vetë stafi, i cili nuk ka qenë pjesë vitale e procesit të krijimit të kësaj kurrikule të re. <i>GVJ rekomandon të lehtësohen lëndët e trungut, dhe të shtohen dhe rishikohen lëndët e profileve për të arritur më mire qëllimit e profilizimit.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit MP në Financë bën kryesisht thellimin e njohurive të fushave përkatëse të financës, si "Bankë, Kontabilitet", "Audit", si dhe fushat e biznesit: "Vlerësim projektesh" dhe "Administrim Publik". Gjithashtu studentët thellohen dhe në njohuritë e kërkimit. Ky përbën në fund të fundit dhe qëllimin e një programi të tillë studimi.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e	Parimi themelor i ndërtimit të programit të lëndës është Parimi i rrathëve. Qëllimi kryesor i këtij parimi është të lehtësojë përshtatjen e studentëve që vijnë nga programe të

studimit dhe sylabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	ndryshme studimi, brenda ose jashtë UET-it, në një program studimi të një cikli më të lartë; plotësimi i njohurive për studentët që i përfundojnë studimet në njërin nga ciklet dhe nuk vazhdojnë më tej studimet e tyre. Parimi i rrathëve shtrihet në të gjithë strukturën pedagogjike dhe shkencore të lëndës ku përfshihet: përmbajtja e njohurive, metoda pedagogjike, bibliografia dhe kontrolli i njohurive. Nga vizitat në institucion rezultoi se studentët e këtij program studimi kanë mësë shumti diplomë bachelori në degë ekonomiku, si Financë dhe Biznes, por në kriteret e pranimit nuk ka kriter të veçantë për këtë diplomë. Për këtë arsye, si dhe për shkak se shumica e studentëve janë në marrëdhënie pune dhe mund të kenë kohë të shkëputur nga shkolla, pedagogët përpiqen për një standartizim dhe thjeshtim të njohurive që parashikohen në programin e lëndës. Kjo gjë ndikon në cilësinë në dalje të studentëve. Gjithashtu, gjatë takimit me studentë, ata konfirmuan se niveli i njohurive të tyre në gjuhën angleze ishte relativisht i ulët. <i>Kjo ndikon në cilësinë e zhvillimit të orës së mësimi duke konsideruar që literatura e rekomanduar është kryesisht në gjuhën angleze.</i>
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik realizon një seance konsultuese, ku orientojnë studentët në lidhje me çështjet ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin përfundimtar. Gjatë seancës trajtohen konceptet kryesore, struktura e përgjithshme e tezës dhe udhëzime të tjera lidhur me natyrën e pyetjeve që do të përfshihen në provimin përfundimtar.
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Pedagogët janë të angazhuar për të ndihmuar studentët dhe me njohuri jashtë programit, kur ata shfaqin nevojë. Në përcjelljen e informacionit mbi zhvillimet e reja të shkencës kanë shërbyer leksionet e hapura me të ftuar nga subjekte të ndryshme.
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Institucioni vë në dispozicion të programit të studimit të gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe laboratore. Por në këtë program studimi në sylabuse nuk ka të programuara orë në laborator. Praktikrat profesionale studentët i kryejnë dhe në qendrat e tyre të punës, duke qenë se shumica e tyre janë në marrëdhënie pune.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën	Në këtë program studimi theksohet më shumë puna e pavarur e studentit, prandaj studentët nxiten në punë në grup të

në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	detyrave të kursit. Gjithashtu sipas takimeve me stafin, rezultoi se pedagogët zhvillojnë dhe raste studimi, mundësisht dhe nga Shqipëria me qëllim rritjen e praktikitetit të lëndës.			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Kryesisht në projekte kërkimore e shkencore si dhe në punime të përbashkëta pedagog-student, nxiten studentët e masterit shkencor dhe të shkollës së doktoraturës. Prandaj ky kriter është më pak i zbatueshëm për këtë program studimi.			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.				
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Institucioni ka një zyrë të projekteve dhe partneriteteve e cila është aktive për realizimin e këtij qëllimi. Shkëmbimet e personelit akademik dhe të studentëve, në kuadër të projekteve të ndryshme kanë mundësuar shkëmbimin e përvojës dhe përfitim të praktikave, të cilat përgjithësisht adaptohen nga personeli akademik pas rikthimit në institucion. Stafi trajnohet herë pas here për metodat e mësimdhënies edhe nga KSBC.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Në programin e studimit Master Profesional në Financë me 5 profile, nuk ka lëndë që kanë parashikuar në programin e tyre zhvillimin e punëve në laborator. Gjithsesi, UET vë në dispozicion një numër të mjaftueshëm laboratorësh shumë cilësorë, të cilët ndihmojnë në përvetësimin e dijeve praktike. Gjithashtu, pjesë shumë e rëndësishme e këtij programi studimi është zhvillimi i praktikës profesionale. UET dhe njëësia bazë garanton sigurimin e vendit të praktikës për secilin

	student të këtij programi pranë institucioneve pritëse dhe bizneseve me të cilat ka marrëdhënie bashkëpunimi. Gjithsesi një pjesë e konsiderueshme e studentëve janë në marrëdhënie pune dhe si rezultat ky problem është i zgjidhur.			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Institucioni mundëson plotësisht zhvillimin e praktikave pranë institucioneve dhe bizneseve me ambjentet më të përshtatshme profesionale, që shkon përshtat profesionit në fushën e financës dhe biznesit, ku dhe ky program studimi është i specializuar, si për shembull: në bankë dhe institucione financiare, në kontabilitet dhe audit, në vlerësim projektsh dhe administrim publik.			
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale ka 6 kredite dhe ajo mbikqyret nga një pedagog i cili në përfundim të saj dorëzon një formular vlerësimi të studentit, formularin e vlerësimit të studentit nga mbikëqyrësi në institucion/organizatë/kompani, formularin e vetëvlerësimit të plotësuar nga studenti dhe raportin përfundimtar të praktikës të përgatitur nga studenti sipas formatit përkatës. Studenti mbron praktikën përpara një komisioni, i cili bën dhe vlerësimin me notë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.9

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Institucioni përmes analizave të kryera dhe vlerësimeve të bëra edhe nga KSBC, ka konkluduar në faktin që studentët me mesatare mbi 7.5 kanë të drejtë të përgatisin diplomë, e cila ka një format të caktuar. Aplikimi për temën e punimit të diplomës bëhet në grup, me 3-5 studentë. Kompozimi i grupit është në vullnetin e lirë të studentëve. Ndërkohë që studentët nën këtë mesatare zhvillojnë provim përfundimtar. Të gjitha këto procedura iu bëhen të njohura studentëve përpara diplomimit. (dokumenti numër 10 B.II. Mbi punimin e diplomës dhe

	<i>disertacionit)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Në të dyja rastet, studentët orientohen nga pedagogu udhëheqës dhe pedagogët e tjerë të departamentit. Në rastin e zhvillimit të diplomës, studenti udhëzohet për temën e zgjedhur, metodologjinë e përdorur dhe literaturën, deri në përfundimin e saj. Kurse në rastin e provimit, studentët zhvillojnë seanca ndihmuese me raste të ngjashme studimi.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi nuk është ritestim njohurish, pasi kjo është menduar si jo efiçente, por një rast studimi që ka lidhje me profilin e zgjedhur. Për zgjidhjen e rastit të studimit shërbejnë njohuritë e marra gjatë programit të studimit.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe vizitave në institucion, çdo anëtar i personelit akademik njofton/përditëson fushat e tij të ekspertizës dhe ofron propozime konkrete për tema diplome ku është i gatshëm të udhëheqë studentë, duke mundësuar krijimin e një inventari me tema diplomash.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Pedagogu udhëheqës ndihmon studentin në zgjedhjen e temës, në strukturën e punimit, në ndërtimin e hipotezave dhe mënyrës së analizës, deri në nxjerrjen e konkluzioneve. <i>(referuar dokumentit numër 10 bashkëngjitur).</i>
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Udhëheqësi garanton cilësinë së punimit të diplomës të studentit. Diploma nuk mund të dorëzohet për mbrojtje nga studenti, pa marrë firmën e pedagogut udhëheqës.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Studentët vlerësohen me notë në përfundim të mbrojtjes së diplomës, dhe rezultatet dorëzohen në sekretari me anë të procesverbaleve, konform rregullores së institucionit. Referuar <i>(pikes 8/8.7 te rregullores se Programit te Studimit)</i> , studenti që merr notë jokalue në sezonin e parë të mbrojtjes së diplomës ka të drejtë të paraqitet për mbrojtje në sezonin e ardhshëm. Studenti ka të drejtë të hyjë

	2 (dy) herë në mbrojtjen e diplomës. Në rast se edhe pas herës së dytë rezulton mbetës, studenti duhet të ndryshojë temën dhe të paraqesë një punim tjetër.			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Sipas rregullores së UET, studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj UET-it dhe ka përmbushur detyrimet përmbyllëse të programit të studimit, pajiset nga institucioni brenda 6 (gjashtë) muajsh me diplomën përkatëse, të shoqëruar me certifikatën e notave të marra gjatë studimeve universitare në UET, me suplementin e diplomës. Studenti pajiset nga institucioni me një vërtetim për diplomën e fituar, të shoqëruar me certifikatën e notave, deri në pajisjen me diplomë.			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studenti i programit MP Financë pajiset me diplomën sipas profilit përkatës, suplementin e diplomës, listën e notave dhe sipas kërkesës nga një kopje të sylabuseve për të gjitha lëndët e përfshira në programin e studimit.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Dokumentacioni i studentëve ruhet nga IAL për një periudhë të pacaktuar që nga koha e rregjistrimit në programin e studimit deri në përfundim të studimeve. Çdo dokumentacion është i arkivuar në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.	Dokumentacioni lidhur me personelin e institucionit, përfshirë personelin akademik efektiv dhe atë me kohë të pjesshme ruhet dhe përditësohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila ruan Dosjen Individuale të Stafit Akademik (<i>Dokument 11 – G. rregullore për burimet njerëzore</i>). Kjo zyrë ruan dosjet individuale të çdo Stafi Akademik (efektiv dhe joefektiv) ku ka informacion: CV, raport shëndetsor, diploma dhe listë notash, trajnime, si dhe raport për vlerësimin e punës për çdo vit akademik. Kjo zyrë mban informacion edhe në lidhje me ngarkesën mësimore të planifikuar dhe realizuar për çdo staf akademik. <i>(Më shumë detaje për përmbajtjen e dosjes për stafin akademik efektiv dhe jo efektiv gjendet në dokumentat 44 dhe 44.1 bashkëngjitur nga UET).</i>
Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Referuar <i>Dokumentit 11 – G. rregullore për burimet njerëzore</i>, Institucioni ka hartuar politikat dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme. Ky dokument ka si qëllim rekrutimin e personelit akademik në përputhje me nevojat për personel akademik, bazuar në planet mësimore që zhvillohen në kuadrin e çdo Fakulteti/Departamenti, si dhe ngarkesat mësimore të miratuara. Synimi kryesor është zhvillimi i ngarkesës mësimore kryesisht me personel të brendshëm e të qëndrueshëm.
Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Procedura e rekrutimit është e njëjtë për të gjithë programet. Departamenti në varësi të nevojave që ka për realizimin e ngarkesës mësimore dhe ekspertizes specifike në lëndë të caktuara përcakton nevojat për pedagogë si dhe kriteret përkatëse. Lajmërimet për vendet vakante bëhen në website-n e universitetit, rrjetet sociale dhe Gazetën Liberale. Një formë lajmërimi për rekrutim stafi gjendet në <i>dokumentin 11.1 Shembull thirrje për staf akademik</i>.
Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të	Institucioni përcakton kritere të përgjithshme dhe specifike rekrutimi në varësi të nevojave që ka departamenti që mbulon programin e studimit. Kryesisht kriter rekrutimi është që kandidati të ketë minimalisht gradën Doktor i Shkencave, por bëhen edhe përjashtime në rastin kur kandidati ka eksperiencë të gjerë dhe ofron ekspertizë në një fushë të caktuar, ose në rastin kur plotësohet nevoja për asistent lektor. Vlerësimi i kandidatëve bëhet nga një juri ku krahas përfaqësues të stafit administrativ dhe përfaqësues të stafit akademik, mund të thirren edhe ekspertë fushe ose tregu, në mënyrë që të

studimit.	përzgjidhen kandidatë sa më cilësorë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i ulët i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se infrastruktura e Institucionit mundëson një mjedis të përshtatshëm për stafin akademik dhe joakademik për të përmbushur objektivat e punës së tyre. Infrastruktura ofrohet për të gjithë duke dhënë në këtë mënyrë mundësi të barabarta për stafin.
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Institucioni organizon një sërë aktivitete, me fokus rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Në këtë kuadër organizohen trajnime të ndryshme, organizon një konferencë shkencore vjetore: "Ditët e Studimeve Shqiptare"; si dhe boton revistën shkencore Revista Economicus e specializuar në fushën e shkencave ekonomike. Gjithashtu UET ka pikë të fortë pjesmarrjen në një numër të konsiderueshëm projektesh ndërkombëtare, të cilët ndikojnë në rritjen profesionale të stafit akademik që angazhohet në këtë program studimi. Për të rritur cilësinë e kërkimit shkencor, stafit akademik ju ofrohet mundësia e fitimit të një granti, nga fondi prej 75.000 Euro i akorduar nga UET për financimin e kërkimit shkencor, nëse botojnë në revistat shkencore të indeksuara në Thomson Reuters (Q1, Q2).
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Institucioni ofron mundësi për trajnime për stafin duke i ofruar qasje ndaj metodave inovative të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjive të reja. Pjesmarrja në projekte ndërkombëtare, ku përfshihet edhe mësimdhënia përveç trajnimit, ka dhënë mundësi të ndarjes së eksperiencave dhe praktikave me partnerët ndërkombëtarë. Të gjitha këto bëjnë të mundur rritjen e mëtejshme profesionale të stafit akademik.

Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Mundësitë e ofruara për stafin akademik në dy kriteret e mësipërme, ndikojnë në kualifikimin e mëtijshëm akademik dhe shkencor të stafit. Përzgjedhja e stafit në përmbushje të nevojave të departamentit për programin e studimit, si dhe ekspertë në fusha të caktuara, si dhe mundësitë për këto kualifikime të mëtijshme dëshmojnë për një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e programit Master Profesional në Financë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Në vizitën në institucion u konstatua që Institucioni ofron mjediset e mjaftueshme dhe me kushte të përshtatshme për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, në varësi të numrit të studentëve të këtij programi studimi. Referuar <i>dokumentit nr.42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit</i> si dhe RVB-së, në mjediset e UET ndodhen: - 10 salla leksionesh të përshtatshme për 150 studentë secila; - 14 salla seminari të përshtatshme për 35 studentë; - 9 salla (leksione + seminare) të përshtatshme për 70 studentë.
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga vizita në institucion u konstatua që mjediset mësimore si klasat e leksioneve dhe të seminareve, laboratorët e informatikës, ishin të pajisura me mjetet e duhura që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik, përmes përdorimit të metodologjive dhe teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënies.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot,	Sallat e leksioneve janë të pajisura me mjete teknologjike të

atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	nevojshme për realizimin me sukses të programit mësimor: PC, projektor dhe foni. Laboratorët janë të pajisur me kompjutera dhe materiale ndihmëse të teknologjisë, por për këtë program studimi në kurrikula nuk janë të parashikuara orë laborator.			
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	Për këtë program studimi nuk janë planifikuar në sylabuse orë laborator, që të kemi mundësi të konkludojmë nëse ka programe profesionale specifike të përshtatshme për lëndët e këtij masteri.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Praktikat realizohen në institucionet me të cilat UET ka marrëveshje bashkëpunimi, ndërkohë që për orët e praktikës që zhvillohen në auditor (4 seanca nga 2 orë) sallat që u përmendën në kriterin 1 të këtij standarti janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të	Institucioni është i pajisur me një bibliotekë e cila ka një sipërfaqe prej 150 m ² . Të gjithë studentët kanë akses për të përdorur bibliotekën, duke siguruar në këtë mënyrë shfrytëzimin në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. Referuar dokumentit 45.1 Dokumenti E-IV. Mbi

barabartë nga studentët e programit të studimit.	<i>funksionimin e Bibliotekës</i> , saktësohet se çdo student dhe pedagog ka të drejtë të shfrytëzojë të gjitha librat, broshurat, revistat, gazetat dhe materiale të tjera në gjuhën shqipe ose në gjuhë të huaj, të cilat gjenden dhe ruhen në Bibliotekë.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka ofron një numër të konsiderueshëm librash në gjuhë të huaj dhe në gjuhën shqipe që përdoren nga studentët si literaturë bazë ose ndihmëse. Referuar (<i>dokumenti 45.2 E-IV-2 Formular per pasurimin e literatures ne biblioteke</i>), literatura përditësohet çdo vit duke marrë në konsideratë kërkesat e pedagogëve. Përveç literaturës fizike, ofrohet edhe akses online në Sage, Ebsco dhe Questia, si dhe akses në katalogun e librave elektronik të bibliotekës. Gjithashtu institucioni është i abonuar në revista shkencore si dhe boton vetë një revistë shkencore ECONOMICUS që përkon edhe me fushën e këtij programi master.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Aksesi në bibliotekat online Sage, Ebsco dhe Questia ofrohet për të gjithë studentët si dhe ofrohet pa pagesë.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Në bibliotekë ofrohet akses në kompjutera (12 gjithsej) dhe në internet në mënyrë që të mos ketë kufizime për studentët në shfrytëzimin e materialeve online. Këto lehtësira u krijojnë kushte studentëve të këtij program studimi për të shfrytëzuar literaturën dhe dokumentacionin që u ofrohet.
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Institucioni ka të parashikuar çdo vit shtimin e literaturave të reja dhe përditësimin e tyre, në varësi të kërkesave të pedagogëve që miratohet nga përgjegjësi i Grup-Lëndëve dhe Përgjegjësi i Departamentit (<i>dokumenti 45.2 E-IV-2 Formular per pasurimin e literatures ne biblioteke</i>). Në rregulloren e UET (<i>dokumenti 5</i>) kërkohet që literature bazë e lëndës (dhe ajo ndihmëse) të jenë të 5 viteve të fundit. Pra vetë rregullorja kushtëzon përditësimin e fondit të literaturës në bibliotekë.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave,	Biblioteka u vihet në dispozicion studentëve në oraret e qëndrimit të studentit në universitet nga ora 9:00-20:00 gjatë ditëve të javës, ndërsa të shtunë nga ora 9:00-17:00. Kapacitetet e bibliotekës me sallën përkatëse është i përshtatshëm dhe në mbështetje të zhvillimit të procesit mësimor, numrit të studentëve.

numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni disponon sistemin UMIS- Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (<i>dokumenti 46 Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS</i>). Ky sistem administron informacionin për studentët që nga regjistrimi i tyre deri në mbylljen e programit të studimit. Informacioni për studentët konsiston në: të dhëna personale, vlerësimet me nota, adresat si dhe nëpërmjet tij bëhet i mundur informimi automatik i studentëve për aktivitete të ndryshme që zhvillohen nga institucioni.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Në UET funksionon sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit. Ky sistem përbëhet nga dy sisteme paralele UMS dhe LMS. Ky i dyti është në shërbim primar të studentëve me synim kryesor rritjen e cilësisë së shërbimit të tyre në çdo hallkë të procesit dhe sigurisht në këtë kontekst edhe të stafit pedagogjik, mësimor kërkimor dhe stafit administrativ. Përmes sistemit UMS mirëmenaxhohet procesi administrativ, institucional duke ofruar gjithë funksionimin e nevojshëm për ofrimin e shërbimit dhe informacionit të nevojshëm për studentët, për programin e studimit, kurrikulën, planin mësimor, sylabuset, sistemin e vlerësimit dhe informacion mbi vlerësimet në çdo kurs dhe diplomimin.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	UET në kuadër të dixhitalizimit të procesit të mësimdhënies, ka ndërtuar Sistemin e Menaxhimit të Mësimdhënies UET LMS. Studentët kanë akses të plotë në të gjithë lëndët e programit dhe materialet e ofruara nga pedagogët e lëndëve: literaturë bazë, literaturë ndihmëse, slides, papers, artikuj, detyra, etj. Ndërkohë edhe pedagogët kanë akses nëpërmjet sistemit në lëndët që ata japin, duke manaxhuar materialet e ofruara për studentët si më lart. Gjatë vizitave në të gjitha

	takimet që patëm me stafin akademik, stafin administrativ dhe studentët u nxorrën në pah avantazhet dhe lehtësitë që ofron ky sistem në procesin mësimor.			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sistemi LMS përveç sa u përmend në Kriterin 3 të këtij standarti, mundëson edhe një komunikim interaktiv ndërmjet personelit dhe studentëve. Studentët dhe pedagogët mund t' i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit, si edhe të komentojnë për detyra, paqartësi, etj. Ky lloj komunikimi ndikon në rritjen e cilësisë së këtij programi studimi.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Platforma LMS garanton monitorimin e aktivitetit akademik pasi të gjitha transaksionet lënë gjurmë. Për më tepër sistemi jep mundësi të gjenerohen statistika për mënyrën se si është përdorur ky sistem nga pedagogët. Të gjitha analizat statistikore ofrojnë informacion për të vlerësuar ecurinë e procesit mësimor në këtë program.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Në faqen e internetit të UET ofrohet një larmishmëri informacionesh në lidhje me programet e studimit, personelin akademik si dhe një vend të rëndësishëm zë publikimi i ilustruar edhe me fotografi i aktiviteteve të ndryshme që zhvillohen pranë tij. Në këtë faqe nuk gjen informacion në lidhje me sylabuset e lëndëve për këtë program studimi. Ky informacion gjendet në sistemin LMS, pra për studentët që fillojnë studimet. Gjatë vizitës, shefi i departamentit konfirmoi që në fillim i publikonin online sylabuset por pastaj vunë re që shumë institucione të tjera ja u kopjonin dhe vendosën të mos i publikojnë më. Ndërkohë të gjithë të interesuarve, gjatë bashkëbisedimit iu ofrohej informacion në lidhje me sylabuset nëse këta do të ishin të interesuar. Informacioni në faqen e Web për momentin ofrohet vetëm në gjuhën shqipe, pasi është ndërtuar faqe e re. Në web-in e vjetër materiali ofrohej në shqip dhe anglisht. Web-i ka filluar të ofrohet dhe në gjuhën angleze por nuk ka përfunduar plotësisht pasi një pjesë e materialeve vazhdojnë të hapen në gjuhën shqipe. Megjithatë edhe në RVB është vënë në dukje që planifikohet që shumë shpejt të ofrojnë Web-in aktual edhe në gjuhën angleze.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare është një komponent i rëndësishëm që siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor. Lidhur me programin e studimit, (<i>evidenca 49 Të dhëna mbi koston për student</i>) paraqiten kostot për student në programet e studimit në përgjithësi, por jo specifikisht për këtë program studimi. Gjatë diskutimeve në institucion, u theksua se kanë në plan për të ardhmen që të bëjnë një analizë kostojë të detajuar për programin, pasi do e bëjnë departamentin qendër kostojë. Gjithashtu referuar <i>evidencës 50 Të ardhura dhe financime të ndryshme</i>, paraqiten disa burime të ardhurash për institucionin që do të mbështesin edhe mbarëvajtjen e këtij programi. Në fund të çdo muaji bëhet një analizë e kostove dhe e të ardhurave, duke krijuar rezerva që t'i përgjigjen sa më mirë nevojave financiare që kanë përparësi për institucionin, në funksion të rritjes së cilësisë së procesit mësimor.
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore të shërbimit të realizimit të programit shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, gratë vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	<i>Institucioni nuk ofron një plan financiar të detajuar për këtë program studimi.</i> Ky plan financiar ku evidentohen financimi i burimeve njerëzore, shpenzimet operationale, shpenzime për bibliotekë, e të ngjashme, realizohet për të gjithë institucionin sipas <i>dokumentave 49 dhe 50 bashkëngjitur nga UET.</i> Institucioni, siç theksohet edhe në RBV konsideron pothuaj të pamundur pasjen e një plani financiar për çdo program për shkak të aktivizimit të stafit akademik dhe administrativ në shumë programe studimi.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të	Referuar RVB, institucioni kryen auditim ligjor të përvitshëm nga audituesi ligjor E.E.I shpk. Ky auditues çdo vit harton një raport në lidhje me transparencën financiare të institucionit, duke analizuar edhe të ardhurat dhe kostot për studentët. Audituesi ligjor i pavarur ofron opinion lidhur me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standartet

hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	kontabël.			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Institucioni nuk dokumenton raporte financiare për programin në veçanti siç u përmend edhe në kriterin 2 të këtij standarti. Ndërkohë këto raporte financiare ofrohen në rang institucioni dhe feedback-u i marrë reflektohet në projekt buxhetin e vitit pasardhës në funksion të mbarëvajtjes normale të programeve të studimit pranë këtij institucioni.			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Pasqyrat financiare të Institucionit dhe raportet e auditit ligjor të pavarur për performancë financiare të institucionit, dëshmojnë se institucioni shfaq qëndrueshmëri financiare dhe ka kapacitete për të përmirësuar situatën financiare në të ardhmen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni në përputhje me ligjin për arsimin e lartë ka miratuar statutin dhe rregulloren që mbulon ciklin e plotë akademik të studentëve, të të gjitha programeve që ofron referuar <i>dokumentit 2 Statuti i UET dhe dokumentit 7 Rregullore e programit MP Financë</i>. Kriteret dhe procedurat për aplikim ofrohen on-line në faqen web të UET, si dhe gjatë fushatës mediatike. Broshura mbi përmbajtjen e programeve gjenden jo vetëm kur shkon për vizitë në institucion, por shpërndahen edhe nga stafi gjatë fushatës së sensibilizimit për pranimet në UET. Gjithashtu për të ndjekur dhe për të qenë më afër studentëve gjatë gjithë periudhës së tyre të studimeve institucioni ka hartuar praktika dhe procedura: Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (dokumenti 12); Mbi tutoriatin, këshillimin akademik dhe këshillimin metodologjik (dokumenti 27.2); Rregullore mësimore MP Financë (dokumenti 7). Institucioni ofron mundësinë e transferimeve të studimeve si brenda UET, ashtu edhe jashtë saj. Studentët e këtij programi kryesisht transferojnë studimet në programin Master Shkencor në Financë (22% e tyre për vitin akademik 2018-2019). Procedura për transferimet dhe njohjen e krediteve prezantohet në dokumentin 28 bashkëngjitur, ndërsa informacioni për transferimet në Masterin Shkencor në Financë ndodhet në dokumentat shtesë të kërkuara institucionit nga grupi i vlerësimit të jashtëm (<i>dokumenti nr. 7</i>).
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Procedurat nga hyrja në dalje të studentëve përmbushen në respekt të drejtave të secilit dhe në frymën e barazisë gjinore. Procedurat janë të parashikuara në rregulloren e programit, janë paraprakisht të njohura nga çdo student dhe monitorohen nga zyra e këshillimit dhe karrierës dhe të dokumentuar elektronikisht dhe fizikisht në zyrat respektive.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të	Një pjesë e kriterëve dhe procedurave për pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve, ndjekjes së studimeve, transferimeve, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë të aksesueshme online në faqen e UET. Pjesa tjetër është lehtësisht e aksesueshme gjatë vizitave në Institucion. Ndërkohë i gjithë materiali është i aksesueshëm nëse studentët janë duke ndjekur studimet pranë UET-së nëpërmjet sistemit LMS. Kriteret dhe procedurat janë të kuptueshme.

aksesueshme nga publiku.				
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Për ndjekjen e këtij program studimi institucioni publikon on line, në media si dhe material të aksesueshëm gjatë vizitave në institucion (apo gjatë fushatës sensibilizuese nga stafi) kritere të përgjithshme që kryesisht konsistojnë në zotërimin e një diplome të nivelit Bachelor. Institucioni nuk aplikon kritere specifike për përzgjedhjen e studentëve për këtë program. Pavarësisht se kjo është në përputhje me Kartën e Bolonjës, institucioni mund të përcaktojë detyrime shtesë, si për shembull marrjen e disa njohurive bazë të nevojshme ekonomike, kur studentët vijnë me diploma bachelor në fushë jo ekonomike. Kjo u evidentua edhe nga takimi me studentët për vështirësitë që hasnin në asimilimin e dijeve në këtë program studimi. Theksojmë këtu karakterin shkencor veçanërisht të disa lëndëve bazë.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Institucioni ndërmerr një fushatë të gjerë sensibilizuese për të rekrutuar studentë e cila konsiston: në publikimet online dhe në media, në vizita të institucione të ndryshme ku ka potencial për rekrutim, si dhe pranë vetë institucionit. Ky informacion si dhe broshurat e shpërndara ofrojnë informacionin e duhur në lidhje me kriteret për ndjekjen e këtij program studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Institucioni ka hartuar rregulloren e përgjithshme (<i>dokumenti 5 bashkëngjitur nga UET</i>) ku janë të përcaktuara procedurat për përparimin akademik të studentëve. Ky informacion vihet në dispozicion nga zyra e pranimeve, zyra e këshillimit të karrierës dhe sekretaria e institucionit. Ndërkohë të gjithë informacionin për lëndët, vlerësimin, literaturën, detyra, ese, etj, studentët e gjejnë në sistemin LMS.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje	Institucioni ka hartuar dokumentin mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin (<i>dokumenti 28 bashkëngjitur nga</i>

me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	UET), i cili ofron gjithë informacionin e nevojshëm për studentët që duan të transferojnë studimet pranë UET. Në rastin e këtij program master më i pranishëm është procesi i transferimit të studimeve prej tij në masterin shkencor në financë. Nga diskutimet me studentët gjatë vizitës në institucion, studentët ishin të mirëinformuar për mundësinë e transferimit si dhe kriteret që duhet të përmbushnin për të kryer këtë procedurë.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Një informacion i përgjithshëm për kriteret dhe procedurat e vlerësimit ofrohet në rregulloren e UET (<i>dokumenti 5 bashkëngjitur nga UET</i>). Ndërkohë kriteret e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë paraqitur shumë më të detajuara në sylabuset e lëndëve (<i>dokumentat 19.1; 1-16</i>). I gjithë informacioni i sylabuseve u paraqitet studentëve në fillim të zhvillimit të lëndës në semestrin përkatës.			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës që në fillim të vitit akademik. Në varësi të notës mesatare ata klasifikohen nëse do të përgatitin punim diplome apo do të japin provim në formën e një rasti studimor. Studentëve iu ofrohet informacion në lidhje me formatin dhe përmbajtjen që duhet të ketë punimi i tyre (<i>dokumenti 10 bashkëngjitur nga UET</i>), ndërkohë që ata sqarohen nga pedagogët për çdo paqartësi apo nevojë që mund të kenë.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Referuar RVB dhe vizites ne institucion, UET ka traditë që në fillim të vitit akademik organizon Javën e Orientimit, ku të gjithë studentët kanë mundësi të informohen për elementët e programit të studimit, si dhe të diskutojnë për të gjithë paqartësitë që kanë. Studentët janë të ftuar në mbledhjen mujore të departamentit, ku ata mund të informohen dhe paraqesin problematikat që mund të hasin. Ndërkohë çdo informacion tjetër ofrohet në kohë reale ose nëpërmjet email-it prej pedagogut të lëndës apo koordinatorit të programit, por edhe nga publikimet në rrjetin LMS.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Institucioni ofron informacion on-line në faqen e tij të internetit mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, nëpërmjet rregullores së programit të studimit. Një informacion më i hollësishëm për elementët e mësipërm ofrohet gjatë vizitës së tyre në institucion nga stafi akademik dhe zyra e kujdesit ndaj studentit.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacionin nëpërmjet rregullores së përgjithshme të UET si dhe mënyrave të shprehura në kriterin e mësipërm. Informacion më i detajuar për sa i takon sylabuseve u prezantohet studentëve nga pedagogu i lëndës ditën e parë që fillon zhvillimi i saj.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni për të orientuar studentët drejt tregut të punës ka ngritur strukturat e mëposhtme: - <i>Zyra e Këshillimit Të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</i> Kjo zyrë ofron informacionet që vijnë nga tregu i punës si dhe informon studentët për kompanitë më të suksesshme në treg, institucionet bashkëpunuese, etj. Të dhëna mbi funksionimin e kësaj zyre gjenden në (<i>dokumentin 12 bashkëngjitur nga UET</i>). Gjithashtu në institucion zhvillohen edhe Panairët e Punës, në mënyrë që studentët të kenë akses të drejtpërdrejtë në punësim. - <i>Bordet e Tregut të Punës</i> , të cilat përbëhen nga të punësuar ish student të UET. Ky bord luan një rol të rëndësishëm në lidhjen institucion- treg pune, si dhe ndikon në përshtatjen e kurrikulave të programit me nevojat e tregut.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Institucioni përditëson në mënyrë të vazhdueshme të gjithë informacionin mbi zhvillimin e procesit mësimor, nëse ka ndryshime që duhen reflektuar. Këto ndryshime afishohen në stendat e departamentit, si dhe ju dërgohen me email studentëve. Ndryshimet që lidhen me materialet mësimore përditësohen në sistemin LMS ku kanë akses individual të gjithë studentët e programit. Në orarin mësimor janë të evidentuara lëndët, pedagogu i lëndës si dhe sallat ku do të zhvillohen orët e mësimi.

Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	Informacioni i përditësuar ofrohet në sistemin LMS, ose u dërgohet me email në adresat elektronike të studentëve. Në të dy këto raste studenti ka mundësi të informohet edhe duke qenë në distancë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nëse përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Referuar dokumentit 29 <i>Të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve</i>, Institucioni përgatit statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në këtë program studimi. Statistikat konsistojnë kryesisht në numrin e studentëve për çdo profil të programit, mesatarja në hyrje, mesatarja në dalje. Sipas (Dokumentit nr. 27 -<i>Cilësia në hyrje dhe dalje Mp Financë</i>), dhe vizitës së GVJ-së, në sekretarine mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi sipas profileve përkatëse për dy vitet akademike ishte: Për vitin akademik 2018-2019; Profili “<i>Administrim Publik</i>”- 9 studentë; Profili “<i>Auditim dhe Menaxhim Risku</i>”- 10 studentë; Profili “<i>Banka dhe Tregje Financiare</i>”- 25 studentë; Profili “<i>Kontabilitet dhe Raportim Financiar</i>”- 56 studentë; Profili “<i>Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh</i>”- 2 studentë; Totali 102 studentë Për vitin akademik 2019-2020; Profili “<i>Administrim Publik</i>”- 3 studentë;

	Profili "Auditim dhe Menaxhim Risku"- 9 studentë; Profili "Banka dhe Tregje Financiare"- 13 studentë; Profili "Kontabilitet dhe Raportim Financiar"- 48 studentë; Profili "Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh"- 1 student; Totali 74 studentë Për sa i përket numrit të të diplomuarve në këtë program studimi rezulton se: Për vitin akademik 2018-2019 janë diplomuar gjithsej për të gjitha profilet 34 studentë;
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në këtë program, largime nga programi, çregjistrime si dhe transferime. Transferimet tek ky program janë drejt masterit shkencor në financë. Të dhëna statistikore lidhur me mesataren në hyrje dhe dalje të studentëve, studentëve të transferuar ofrohen edhe nga (dokumenti 27. Cilësia në hyrje dhe dalje MP në Financë), për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Nga dokumenti shtesë nr. 7 i kërkuar në institucion rezulton se nga 102 studentë që u regjistruan në këtë program studimi për vitin 2018-2019 ka 3 çregjistrime dhe 22 transferime për në master shkencor në financë (ndërkohë në RVB është deklaruar që janë 6 transferime për në master shkencor në financë).
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit, deri në diplomimin e tyre.	Institucioni disponon statistika për ecurinë e studentëve deri në diplomimin e tyre. Referuar dokumentit 38 Raporti paraprak i vleresimit të programit MP Financë, Institucioni ka hartuar analizën vjetore mbi arritjen e objektivave formuese të rezultateve të pritshmërisë të të nxëniet dhe aftësimit profesional. Ofrohet informacion në lidhje me kalueshmërinë, studentët që nuk kanë hyrë në provim, studentë që kanë finalizuar studimet me punim diplome apo me provim. Për çdo student është krijuar një dosje personale që disponohet nga sekretaria mësimore.
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e	Në të dhënat e studentit ka të drejtë akses vetëm vetë studenti dhe persona të autorizuar nga institucioni. Sistemi i manaxhimit të informacionit nuk lejon akses në të dhënat e studentit as të studentëve të tjerë, pedagogëve apo stafit administrativ. Ky sistem ka për funksion ruajtjen, manaxhimin dhe përpunimin statistikor të të dhënave duke

autorizuar.	bërë që këto të dhëna të përpunuara të jenë lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar nga institucioni.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Për çdo program studimi, institucioni harton raporte analitike mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve si dhe shkallën e punësimit të tyre. Informacioni për vitin akademik 2018-2019 ndodhet në (<i>dokumentin nr.27</i>) bashkëngjitur nga UET. Ndërkohë Zyra e këshillimit dhe karrierës në bashkëpunim me rrjetin ALUMNI merr informacion të përgjithshëm për punësimin e studentëve, këtë informacion e zotërojnë për të gjithë programet dhe jo specifikisht për programin Master Profesional në Financë. Nota mesatare e studentëve që janë rregjistruar në këtë program studimi varion nga 5,51 në 6,68.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk është përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Referuar (<i>dokumenti 2 statuti i UET, neni 51.5</i>) është përcaktuar roli i këshillave të studentëve të cilët shprehin mendime dhe propozime për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve dhe zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj. Studentët marrin pjesë në: - Në Komisionin e brendshëm të cilësisë ka një anëtar përfaqësues të këshillit të studentëve; (<i>neni 16.2</i>) - Anëtarë të senatit akademik janë kryetari i këshillit studentor dhe 2 studentë të tjerë që zgjidhen prej këtij këshilli (<i>neni 19.2.4</i>) Gjithashtu studentët janë të ftuar për të marrë pjesë në mbledhjen mujore të departamentit.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit	Përveç përfshirjes institucionale të studentëve, sqaruar në

të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	kriterin e mësipërm, institucioni në mënyrë periodike realizon diskutime në fokus grupe, pyetësorë online lidhur me cilësinë e mësimdhënies si dhe sugjerime për ndryshime. Gjatë vizitës në institucion në takimin me studentë ata pohuan diçka të tillë. Ndërkohë institucioni ka vendosur që një nga anëtarët e grupit të hartimit të RVB të ishte student nga masteri profesional në financë, duke bërë të mundur përfshirjen në të edhe të opinionit real të studentëve.
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Institucioni në hartimin dhe përmirësimin e kurrikulës së programit konsideron ngarkesën akademike të studentëve në këtë program studimi. Kështu program ka kohëzgjatje 1-vjecare të shpërndarë në dy semestra. Në semestrin e parë studentët ndjekin 4 lëndë, ndërsa në semestrin e dytë ndjekin 3 lëndë mësimore, por ndërkohë realizojnë edhe praktikën profesionale si dhe gjatë këtij semestri punojnë për realizimin e punimit përfundimtar për përmbylljen e studimeve. Në opinionin tonë, kjo është një ndarje e drejtë ngarkese për studentët.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Institucioni nxit studentët që të japin opinionin dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e programeve të studimit. Kjo realizohet nëpërmjet diskutimeve me studentët në fokus grupe, mbledhjes së pyetësorëve online si dhe ftesës së studentëve për pjesmarrje në mbledhjen mujore të departamentit.
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentët njihen me mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe ndarjen e vlerësimeve gjatë vitit në rregulloren e UET dhe specifikisht në sylabusin e çdo lënde. Institucioni ka përcaktuar korrigjimin e provimit mbas kryerjes së procesit të sekretimit. Në këtë mënyrë garantohej drejtësia dhe barazia në korrigjim. Ndërkohë studenti ka të drejtën e ankimimit për provim, duke i dhënë mundësi që të shoh provimin dhe të diskutojë me pedagogun e lëndës rreth korrigjimit të provimit. Studentët kanë të drejtë që kundrejt dorëzimit të një formulari ankese (<i>dokumenti 40.1 bashkëngjitur nga UET</i>) të kërkojnë sqarim për korrigjimin e provimit. Për këtë ankesë jep mendim drejtuesi i departamentit, i cili në bashkëpunim me dekanin dhe zv.rektorin marrin një vendim për procedim të mëtejshëm.
Shkalla e përmbushjes së	Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet

standardit	përmthshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Institucioni ka mundësuar ngritjen e Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit, e cila është edhe njësi e posaçme për informim dhe shërbim ndaj studentëve. Funksionet dhe detyrat e Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit rregullohen nëpërmjet dokumentit (<i>Dokumenti 12. E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit</i>). Kjo zyrë ndjek studentët nga moment kur ata regjistrohen për të filluar studimet pranë institucionit deri në përfundim të tyre. Kjo zyrë ofron informacionin e nevojshëm për çdo paqartësi apo nevojë të studentëve në funksion të procesit mësimor. Çdo department ka zgjedhur një këshillues karriere i cili gjithashtu ofron konsulencë për studentët. Këshillimi dhe kujdesi ndaj studentëve ofrohet edhe nëpërmjet tutoriatit dhe këshillimit akademik (<i>Dok. Nr. 27.2 Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik</i>).
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .	Zyra e kujdesit ndaj studentit, e mbështetur nga puna e këshilluesit të karrierës pranë departamentit dhe gjithë stafi akademik i departamentit që mbulon këtë program studimi, bëjnë të mundur informimin, këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve për çështje që lidhen me procesin mësimor.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me	Institucioni ka ngritur Zyrën e Këshillimit të Karrierës, krahas Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit. Të dyja këto zyra në bashkëpunim me njëra-tjetrën ndjekin në vazhdimësi ecurinë e studentëve. Këto dy zyra kujdesen që studentët të orientohen për realizimin e praktikës profesionale pranë institucioneve më të përshtatshme për formimin e tyre, si dhe t'i orientojë ata drejt tregut të punës, duke konsideruar prioritetet momentale të punësimit. Ndërkohë, gjatë gjithë periudhës së studimeve të

kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	tyre studentët kanë asistencën e pedagogëve të departamentit dhe më gjerë për t' i këshilluar dhe informuar në lidhje me tregun e punës.			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	Ky program studimi është hapur për herë të parë në vitin akademik 2018-2019, kështu që nuk ka shumë të dhëna për punësimin e studentëve pas diplomimit. Institucioni ka eksperiencë nga programi i mëparshëm i studimeve master në financë dhe programet e tjera. Zyra e këshillimit të karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit, në bashkëpunim me rrjetin ALUMNI të UET-së mbledhin të dhëna për punësimin e studentëve mbas përfundimit të programeve të studimit. Këto të dhëna mbahen në rang Institucioni dhe jo specifiku për çdo program. Përfaqësues të rrjetit ALUMNI kanë krijuar dhe Bordin e Tregut të Punës për departamentin. Nga diskutimi me Dekanin dhe stafin akademik doli në pah që opinioni i anëtarëve të Bordit të Tregut të Punës konsiderohej me mjaft vlerë në përmirësimin e kurrikulave dhe të gjithë procesit mësimor në funksion të orientimit drejt tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC),	UET harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Ai realizohet përmes organeve drejtuese të UET, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e

në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore të UET dhe harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Këto raporte vihen në dispozicion dhe diskutohen në të gjitha nivelet e UET.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	UET ka ngritur disa struktura në funksion të sigurimit të cilësisë. - Njësia kryesore është Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili përgjigjet për përmbushjen e standarteve dhe kriterëve të programit të studimit. Në strukturat e ngritura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KSBC) (<i>Statuti, neni nr. 16 pika 2</i>) përfshihen edhe studentë dhe ekspertë të jashtëm. KSBC rishikon rregulloret e UET, dhe programet e studimit sipas objektivave të institucionit; merr pjesë në analizën SWOT; monitoron procesin e provimeve dhe të vlerësimit të tyre, të përgatitjes së sylabuseve si dhe përditësimin e literaturës, të sekretarisë në hedhjen e notave, etj; - Departamenti përgjigjet për përmbajtjen e programit të studimit, në termat e vlerësimit të programeve ekzistuese dhe propozimin e kurrikulave të reja, dhe kalimin e tyre për miratim në Senat; - Zyra e zhvillimit të kurrikulave kontrollon plotësimin e kriterëve dhe standarteve të programeve të reja dhe atyre ekzistuese të studimit; - Bordi i Tregut të Punës/ALUMNI, japin ide të reja dhe feedback nga tregu i punës dhe kërkesat e tij. Këtu ndihmojnë dhe ekspertët e jashtëm; - Pyetësorët dhe fokus grupet ndihmojnë në përfshirjen e studentëve në vlerësimin e procesit mësimor;
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë	Përveç instrumentave të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ku UET ka angazhuar personel akademik dhe ndihmës, ekspertë të jashtëm si dhe studentë; gjithashtu institucioni ka kaluar në mënyrë periodike dhe të suksesshme proceset e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit. Në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë, UET i është nënshtruar vlerësimit periodik institucional (me vlerësim përfundimtar pozitiv dhe me një kohëzgjatje prej 5 vite akademike sipas vendimit të BA nr. 12, datë 07.04.2017) dhe të programeve të

cilësinë.	studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	UET ka një strategji të përcaktuar qartë të sigurimit të brendshëm të cilësisë, të mbështetur me një plan veprimi, ku KSBC përpiqet të garantojë cilësinë në drejtim të kurrikulave, cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor, mbështetjes së studentëve, dhe në këtë proces kjo njësi bashkërendon punën e të gjitha njësive dhe zyrave të angazhuara. Nëpërmjet akteve rregullatore, ka përcaktuar detyrat dhe funksionet e strukturave të ngritura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (<i>Dokumenti 8. F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë</i>), që synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	Nga vizita në institucion u konstatua se programi i studimit MP në Financë me 5 profile, me vit fillimi 2018-2019, është rezultat dhe frut i ndryshimit të kurrikulës së mëparshme në bazë të politikës së re të institucionit, riorganizimit të tij dhe të gjithë programeve të studimit, konceptimit të ri të masterave profesionale me profile multidisiplinore, ku 3 profile i mbulon njësia përgjegjëse dhe 2 profile mbulohen nga njësitet e tjera. Ky ndryshim u bë nën kujdesin e KSBC dhe Zyrës së Kurrikulave, pasi u plotësua kuadri nënligjor i ligjit të arsimit të lartë nr. 80/2015, dhe u përshtat me kërkesat e tregut sipas propozimit të bërë nga njësia bazë përgjegjëse. Në këtë rishikim ndikuan dhe faktorë të tjerë, si Bordi i Tregut të Punës i cili ka në përbërje të tij ish studentë të UET, të cilët sjellin mendimet e tyre në lidhje me dijet më të nevojshme për tregun deri në përditësimin e sylabuseve. KSBC është një njësi shumë e rëndësishme për institucionin, e cila ka në përbërjen e vet përfaqesues të stafit akademik të secilit fakultet, të stafit administrativ, të studentëve dhe një ekspert të jashtëm. KSBC

	ka objektiva të përcaktuara qartë të cilat i ndjek me rigorozitet.			
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	KSBC ka një rregullore ku përcaktohen qartë të gjithë mekanizmat e përdorur prej saj për monitorim. UET harton një raport vlerësimi periodik mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar (<i>Dok. Nr. 38 Raporti paraprak i vlerësimit të programit MP Finance</i>). Këto raporte janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel rektorati sikurse dhe në nivel departamenti.			
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Vlerësimi dhe monitorimi kryhet në disa elementë të programit të studimit, si monitorimi i procesit të provimeve dhe vlerësimi i tyre, formati dhe përmbajtja dhe përditësimi i sylabuseve, matja e performancës së kërkimit shkencor, krijimi i fokus grupeve, vlerësimi i pedagogëve përmes fokus grupeve dhe pyetësorëve online, etj. Secili prej këtyre proceseve ka një metodologji të caktuar të përcaktuar qartë në manualin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Aktivitetet e vlerësimit dhe monitorimit të programit të studimit hartohen nga KBSC dhe miratohen nga rektori në formën e planit të veprimit (<i>Dok. Nr. 30. Plan i Veprimit_KSBC_2018-2019</i>).			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Çdo element që monitorohet për cilësinë e tij raportohet përmes një formati të caktuar (si për shembull formati i relacionit mbi përputhshmërinë e sylabuseve, formati i vlerësimit të pedagogut nga studenti, formati i vlerësimit të pedagogut nga eprori/titullari i gruplëndës, etj) tek përgjegjësi i departamentit dhe dekani i fakultetit.			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit të aktivitetit mësimor dhe kualifikimit shkencor është përmirësimi i mëtejshëm i mësimdhënies. KSBC ndjek procesin e monitorimit deri në evidentimin e masave të marra në funksion të analizës së kryer. Rezultatet e nxjerra nga procesi i vlerësimit i shërbejnë drejtuesve për të ndërmarrë aktivitete në kuadër të përmirësimit dhe qëndrueshmërisë së programit të studimit MP në "Financë" (<i>Dok. Nr. 38 Raporti paraprak i vlerësimit të programit MP Finance</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit përbën një proces periodik, kalon në të gjitha hallkat dhe njësitë e përfshira me një metodologji të përcaktuar qartë. KSBC kryen vlerësimin e brendshëm në nivel institucional dhe përfshin të gjithë programet e studimit. Kjo analizë përdoret për reflektim nga njësitë bazë dhe përfshihet në vetëvlerësimin periodik dhe institucional.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Metodologjia e sigurimit të brendshëm të cilësisë tashmë është e kristalizuar dhe ka rezultuar eficiente në reflektimine saj dhe në marrjen e informacionit të nevojshëm dhe vendimeve të duhura. Duke qenë një program studimi i nivelit të dytë, në vlerësimin e cilësisë përfshihen edhe më shumë mendimi dhe vlerësimi i ekspertëve të jashtëm nga tregu i punës, i cili ndikon në gjykimin e kurrikulave dhe mbështet praktikën profesionale.
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	UET për të arritur një prej objektivave kryesorë të saj, atë të sigurimit të cilësisë, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: • sondazhe e intervista të studentëve aktualë (përmes pyetësorëve online, fokus grupeve të krijuar, mbledhjeve të hapura në departament çdo muaj, etj). Këto instrumenta përdoren për të vlerësuar çdo lëndë, çdo sylabus, çdo pedagog, çdo program studimi. Në këtë mënyrë reflektohet mbi cilësinë e mësimdhënies dhe metodat e përdorura për përcimin e dijeve dhe vlerësimin e tyre; • Sondazhe dhe intervista me stafin akademik, ku këtu përfshihet dhe vlerësimi që i bëhet pedagogut nga përgjegjësi i departamentit dhe titullari i gruplëndës; • Sondazhe dhe intervista me studentët alumni për të perceptuar suksesin e programit në tregun e punës. Këtë

Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	reflektim e konsiderojmë shumë të rëndësishëm në rastin konkret pasi ky program studimi përbën një kurrikulë të re që po testohet nga tregu i punës; Gjithashtu, institucioni ndërthur dhe metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit. Këto metoda përfshijnë: • Vlerësimi me nota/pikë; • Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; • Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; • Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; • Dëgjime në auditor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	UET përveç hallkave të brendshme të institucionit të përfshira në këtë proces të rëndësishëm të përmirësimit dhe të monitorimit të cilësisë, përfshin dhe ekspertë të jashtëm, të cilët monitorojnë tregun e punës dhe japin kontributin e tyre përmes eksperiencës në punë me përditësimin e kërkesave të tregut për profesione në fushën e financës, dhe në dy profile të fushës së biznesit. Gjithashtu UET është i përfshirë si partner në dy projekte të cilat merren me sigurimin e cilësisë së brendshme në institucionet e arsimit të lartë, konkretisht projekti ENCHASE dhe QainAL. Kjo pjesëmarrje ndihmon në përditësimin e akteve rregullatore, metodologjive dhe instrumentave të përdorur për vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë, si dhe me shkëmbimin e eksperiencave dhe trajnimit e mëtejshëm të stafit dhe palëve përfshirëse në proces.

Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Secila prej palëve të përfshira në procesin e vlerësimit të cilësisë (KSBC, Zyra e Kurrikulave, Stafi, studentët, etj.) i kanë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë në rregulloren përkatëse. (<i>dokumenti 8 F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë</i>).			
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademi e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Nga vizita në institucion, nga takimet me grupet e interesit, si dhe mbi bazën e dokumentacionit rezultojnë se UET ka ndërtuar një sistem të sigurimit të cilësisë me përvojën e duhur për të përfshirë dhe monitoruar të gjitha hallkat dhe njësitë përgjegjëse. Shumë të rëndësishme paraqiten hallkat e brendshme me në krye njësinë bazë mbështetëse: Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, por dhe njësia mbështetëse Departamenti i Manaxhimit dhe Marketingut, që plotëson dy profilet e tjera. I gjithë stafi është i angazhuar në proces duke rishikuar sylabuset, literaturën, metodat e mësimdhënies të përdorura, korrektësinë në vlerësimin e provimeve, në funksion të përmirësimit të cilësisë. Zyra e kurrikulave dhe KSBC si njësitë bazë të monitorimit të cilësisë, të vendosjes së standarteve dhe plotësimit të tyre, trajtojnë herë pas here stafin akademik dhe atë ndihmës në këtë proces. Studentët janë faktori kryesor në nxitjen e rritjes së cilësisë dhe opinioni i tyre është fjala kyçe e të gjitha metodave të përdorura për monitorim të vazhdueshëm. Por cilësia përmirësohet edhe përmes ndikimit të faktorit dhe opinionit të jashtëm, direkt nga tregu i punës, përmes angazhimit të studentëve alumni, pjesë e bordeve të tregut të punës dhe panairove që zhvillohen. Mbi bazën e informacionit të mbledhur, analizave të kryera pranë departamenteve dhe fakulteteve, KSBC harton një analizë vjetore dhe rezultatet e këtij monitorimi u transmetohen drejtuesve me synim marrjen e masave për përmirësim të cilësisë.			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.				
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për

programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	UET harton politika dhe strategji për organizimin dhe veprimtarinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, dhe i dokumenton ato në dokumenta të cilët janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe palët e interesuara. UET përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët etj., si dhe për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit. Rezultatet finale të pyetësorëve, fokus grupeve dhe analizave të tjera, bëhen publike në mënyrë që të ruhet etika akademike dhe privatësia.			
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.				
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.				
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në rast të evidentimit të problemeve, ato adresohen në formën e duhur dhe të parashikuar dhe merren masa për përmirësimin e tyre. Kryhet një proces follow up përmes të cilit drejtuesit e institucionit bëjnë vlerësimin e performancës akademik të secilit pedagog. Stafi akademik nxitet në trajnime të vazhdueshme për përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe përfshihen në trajnime në institucionet homologe në kuadër të projektit Erasmus+.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Në bazë të dokumentave të vënë në dispozicion, dhe vizitave të kryera, UET dëshmon për një seriozitet dhe eksperiencë të mirë të procesit të sigurimit të cilësisë së brendshme.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Periodikisht pedagogët dhe studentët informohen me procesin e sigurimit të cilësisë dhe monitorimit të procesit mësimor, akademik dhe cilësisë së programit të studimit. Për këtë shërben java e informimit për studentët përpara fillimit të procesit mësimor, përfshirja e studentëve në organe të ndryshme drejtuese si Senat, KSBC, në mbledhjet e hapura të departamentit, etj, si dhe njohja e rregulloreve të institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në: “Financë” me profile “Bankë dhe Tregje Financiare”, “Auditim dhe Menaxhim Risku”, “Kontabilitet dhe Raportim Financiar”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

- Projektet ndërkombëtare.** Institucioni merr pjesë në një numër të konsiderueshëm projektesh ndërkombëtare duke ndikuar në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, ngritjes akademike dhe shkencore të stafit akademik, ngritjes profesionale të stafit administrativ dhe pasurimit të universitetit me salla laboratorit dhe pajisje bashkëkohore;
- Sistemi LMS.** Investimi në këtë sistem ka rritur lehtësinë dhe shpejtësinë e komunikimit me studentët, si dhe u ka krijuar studentëve akses në të gjitha materialet e ofruara nga pedagogët. Studenti gjen online të gjithë informacionin e tij individual;
- Bordi i tregut të punës.** Ky organizëm, i krijuar nga ish studentë ALUMNI krijon mundësinë që Institucioni të sigurojë një feedback nga ndryshimet dhe nevojat e tregut të punës, nga individitë të cilët njohin shumë mirë edhe vetë Institucionin;
- Biblioteka fizike dhe online.** Biblioteka e pasur si në aspektin fizik të literaturës, ashtu edhe atë online;
- Literaturë koherente.** Ofrimi i literaturës së viteve të fundit, kryesisht nga pesë shtëpitë botuese ndërkombëtare më prestigjioze;
- Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë** mbështetet me një plan veprimi, ku KSBC përpiqet të garantojë cilësinë në drejtim të kurrikulave, cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor, mbështetjes së studentëve, dhe në këtë proces kjo njësi bashkërendon punën e të gjitha njësive dhe zyrave të angazhuara;
- Trajnimet e vazhdueshme** të studentëve përmes orëve të hapura të ekspertëve të fushës, panairëve të punës, trajnimet periodike të stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien, kërkimin, projektet dhe metodologjinë, si psh: Staff Development Day. Vlerësohen marrëdhëniet e ngushta me institucionet e tjera dhe biznesin;

b. Pika të dobëta:

1. Kurrikula e Masterit Profesional në Financë me Profile.

- në këtë program me kohëzgjatje një vit akademik, ka shumë lëndë të disiplinës shkencore përkundrejt atyre profesionale;

- Në këtë program ka lëndë të karakterit thellësisht shkencor të përshtatshme për kurrikul masteri shkencor;
 - Në profilin e Kontabilitet dhe Manaxhim Risku mungojnë lëndë në fushën e manaxhimit të riskut;
 - Në profilet "Administrim Publik" dhe "Manaxhim Projektesh" nuk mendojmë që krijohet profilizimi i duhur për studentët;
- 2. Masteri Shkencor në Financë zhvillon të gjitha lëndët që zhvillon Masteri Profesional në Financë.**
- 2.1** Syllabuset e lëndëve që zhvillohen në të dy masterat janë njëloj si për studentët e masterit profesional, ashtu edhe të masterit shkencor. Psh. Masteri Shkencor me drejtim Banka dhe Tregje Financiare ka të gjithë lëndët që zhvillon Masteri Profesional në Financë me drejtim Banka dhe Tregje Financiare dhe i zhvillon me të njëjtat syllabuse;
- 2.2** Zhvillimi i lëndës bashkarisht i studentëve të këtij programi profesional me ata të Masterit Shkencor bën që niveli i njohurive të përshtatet për studentë me mesatare të ulët, siç evidentohet nga vetë staf;
- 3. Ndryshimi i shpeshtë i stafit.** Ky ndryshim është i dukshëm jo vetëm në rang pedagogësh në departamentin përgjegjës për këtë program, por edhe në pozicione drejtuese. Ndryshimi është evident për dy vitet akademike 2018-2019 dhe 2019-2020 të zhvillimit të këtij programi masteri. Kjo ndikonte në masën e angazhimit në kurrikulën e programit të stafit ekzistues;

Rekomandime:

1. Të rishikohet kurrikula në funksion të profilizimit më të mirë të këtij masteri.
 - Kjo nënkupton që lëndët e disiplinës shkencore të jenë më shumë të karakterit profesional, pasi janë disiplina të thelluara shkencore. Rekomandojmë heqjen e lëndës Teoritë Financiare nga kurrikula e këtij programi, pasi është lëndë e karakterit thellësisht shkencor e përshtatshme për kurrikul masteri shkencor;
 - Duhet të shtohet numri i lëndëve të karakterit profesional duke pasur një numër më të vogël kreditesh, në respekt të kriterëve në VKM nr 41;
 - Rekomandojmë shtimin e 1-2 lëndë të fushës së manaxhimit të riskut në masterin profesional me drejtim Auditim dhe Manaxhim risku;
 - Gjithashtu sugjerojmë, që të rishikohen të dy profilet e manaxhimit, mundësisht përmes një debati të hapur, ku të përfshihen më shumë staf akademik;
2. Programet Master Profesional në Financë dhe Master Shkencor në Financë nuk duhet të kenë një përputhje kaq të madhe në kurrikulën e tyre. Masteri profesional në financë nuk mund të jetë baza për masterin shkencor në financë, pasi kanë fokus shumë të ndryshëm. Kjo gjë duhet të evidentohet edhe në syllabuset e lëndëve pasi janë të njëjta (mund të jenë të njëjta për 1-2 lëndë por jo për të gjitha);

3. Studentët e masterit profesional nuk mund të zhvillojnë të gjitha lëndët bashkë me studentë të masterit shkencor. Rekomandojmë që syllabuset të përshtaten për secilin program studimi dhe lëndët të zhvillohen në mënyrë të ndarë për masterin shkencor dhe profesional, pasi kjo ndikon në cilësinë e programit të studimit;
4. Duke qenë se ky është viti i dytë i zhvillimit të këtij program studimi, analizat i referohen më së shumti programit të vjetër të masterit profesional në Financë, i cili ka ndryshuar thelbësisht. Prandaj rekomandojmë që të merret feedback nga studentë në lidhje me cilësinë e programit dhe sa e përshtatshme ka qenë kjo kurrikul me nevojat e tregut të punës, për të plotësuar kriterin e analizës së tregut për këtë program studimi;
5. Të ndahet pozicioni i Dekanit nga Shefi i komanduar i Departamentit. Pavarësisht se ligji nuk specifikon saktësisht që nuk duhet të jetë i njëjti person, fakti që në rastin e parë kemi të bëjmë me drejtues të njësisë kryesore, dhe në të dytin me drejtues të njësisë bazë, mendojmë që ndërmjet dy pozicioneve drejtuese ka konflikt interesi;

Evaluation Process of the study program "Professional Master in: "Finance", with profiles: "Banking and Financial Markets"; "Audit and Risk Management"; "Accounting and Financial Reporting"; "Public Administration"; "Project Management and Evaluation"

a. Strengths:

1. **International projects.** The institution participates in a significant number of international projects impacting the quality of teaching, academic and scientific development of academic staff, professional development of administrative staff and enrichment of the university with modern laboratory and equipments;
2. **The LMS system.** Due to the LMS system the communication with students is easier and faster, giving them access to all materials provided by the lecturers. The student may find all of individual information online;
3. **Labor market board.** The board made of former ALUMNI students, creates the opportunity for the Institution to get feedback on the changes and needs of the labor market, from individuals very familiar with the Institution;
4. **Physical and online library.** A rich library of both physical and online literature;
5. **Coherent literature.** The Institution is offering the literature of recent years, mainly from the five most prestigious international publishing houses;
6. **The Internal Quality Assurance System** is supported by an action plan in order to guarantee quality in terms of curricula, teaching quality, research and student support. This unit coordinates the work of all units and offices responsible for this program;
7. **Continuous training** of students through open hours with field experts, job fairs, and periodic staff training in areas related to teaching, research, projects and methodology such as Staff Development Day. Close relationships with other institutions and businesses are considered valuable;

b. Weaknesses:

1. The Curriculum of Professional Master in Finance (with Profiles)

- In this one-year academic program, there are many subjects of scientific discipline compared to the professional ones.
- In this program there are deeply scientific courses suitable for the curriculum of the Master of Science;
- The curricula of the "Accounting and Risk Management" profile of this Master, has no course or module on risk management;
- We think that the curriculum for "Public Administration" and "Project Management" does not provide the proper profiling for students;

2. The Master of Science in Finance offers all courses as the Professional Master in Finance.

2.1 The syllabuses of the subjects taught in both masters are the same for professional and science master's students. For example, the Master of Science in Banking and Financial Markets has all the subjects taught by the Professional Master in Finance in Banking and Financial Markets. The syllabuses for these courses are the same as well;

2.2 Teaching the courses jointly for students of this Professional Master with those of the Master of Science makes that the level of knowledge offered is adapted for students of lower average marks, as identified by staff;

3. Frequent staff changes. These changes have happened not only in the staff of responsible department for this program, but also in leadership positions (for the two academic years, 2018-2019 and 2019-2020 that this master's program has been running). This has affected the level of existing staff engagement in the curriculum development;

Recommendations:

1. To review the curriculum in order to better profile this master.

- This means that the subjects of scientific discipline should be more of a professional character, as they are deep scientific disciplines. We recommend removing the subject of Financial Theories from the curriculum, as it is a deeply scientific subject suitable for a Master of Science curriculum;
- The number of professional subjects should be increased which may require a review of allocation of credits, in compliance with the criteria in VKM No. 41;
- We recommend adding one or two courses on risk management for the profile: Audit and Risk Management;
- We also suggest reviewing both profiles in the field of management, possibly through an open debate, involving more academic staff;

2. The programs of Professional Master in Finance and Master of Science in Finance do not have to be fully complied in their curricula. A professional master in finance cannot be the basis for a master of science in finance, as they have a very different focus. This

- should also be noted in the courses syllabuses as they are the same (they can be the same for one to two subjects but not for all of them);
- Students of Professional master should not attend all courses together with students of Master of Science. We recommend the syllabuses be adapted for each study program and the courses to take place separately, as this may impact the quality of the program;
 - As this is the second year of this study program, the analysis mostly refers to the old professional master's program in Finance, which has changed substantially. Therefore, we recommend the institution to get feedback from the students of these two academic years on the quality of this program and how appropriate this curriculum has been to the needs of the labor market, in order to meet the market analysis criteria for this study program;
 - The position of the Dean of the Faculty should be separate from the Acting Head of Department. Although the law does not state it explicitly, the fact that in the first case we are dealing with the head of the main unit, and in the second with the head of the basic unit, we think that there is a conflict of interest between the two management positions;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANACIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN				X

E PROGRAMIT TË STUDIMIT				
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc. Dr. Dorina KRIPA

Prof.Asoc. Dr. Brikena LEKA

